

## Ky është thjesht racizëm!

Zoti Foto Duka, banor i Kuçovës tallet me qytetarët e Beratit duke ndërprerë rrymën elektrike kur i do atij qejfi dhe kur e urdhërojnë ata që i rrinë sipër. Anuk paska Berati një djalë a vajzë që të drejtojë filialin e KESH-it për Beratin?! Ky djalë a vajzë do të skuqej para bashkëqytetarëve nëse do të silllej si Foto Duka nga Kuçova që e ndërpret energjinë elektrike dhe e sjell atë sipas humorit të tij dhe të atyre që i rrinë sipër.

Në qytetin e Beratit drita elektrike vjen kur t'i teket filialit të KESH-it në Berat dhe drejtorit, z.Foto Duka nga Kuçova. Energjia ndërpritet pa paralajmërim në orën 8, 9, 10, 11, 12 dhe vjen në orën 17, 18, 19 e 20., pa përfillur asnjë lloj kontrate me qytetarët e Beratit, pa përfillur asnjë lloj të drejte njerëzore të atyre që banojnë në hapësirën ku operon filiali i KESH-it.

Z.Foto Duka dhe ata që i rrinë sipër ka në dorë orët më intensive të jetës së qytetarëve. Ai vendos kur ato duhet të jetojnë si njerëz dhe kur të jetojnë si kuaj të vjedhur në hauret e tyre apo si të marrë peng nga filiali i KESH-it

Z.Foto Duka dhe ata që rrinë sipër kanë në dorë tërë biznesin e qytetit të Beratit. Ai ndërpret energjinë kur i do qejfi atij dhe atyre që rrinë sipër dhe biznesi i Beratit po vdes çdo ditë nga mungesa e energjisë elektrike.

Filiali i KESH-it është aq i paturpshëm, saqë nuk lajmëron klientët e vet kur do t'u ndërpritet energjia elektrike, kur do t'u vijë energjia elektrike dhe nuk bëhet kurrë fjalë për t'u kërkuar ndjesë klientëve që paguajnë deri në një faturat e KESH-it.

Filiali i KESH-it në Berat është një nga institucionet më të pareformuara të të gjithë institucioneve në Shqipëri. Piramida e kuqe që nuk pyet për të drejtat e qytetarëve, që nuk pyet për kontratat me qytetarët, që nuk do t'ia dijë për shkatërrimin e biznesit, e ka emrin KESH. Ndërkohë që eksportohen jashtë shtetit aktualisht miliona kilovatorë, ky bunker i kuq shkel me të dy këmbët barazinë midis shtetasve. Në Sarandë, Vlorë, Durrës, Tepelenë, Gjirokastrë energjia nuk ndërpritet kurrë. Mos vallë qytetarët e Beratit janë të dorës së dytë?

Mos vallë qytetarët e Beratit që paguajnë me korrektesë faturat e KESH-it paguajnë haraç për krahina, domene a qytete të pushtetarëve të lartë?

Filiali i KESH-it në Berat është një bunker tipik komunist që nuk do t'ia dijë për të drejtat elementare të qytetarëve. Berati aktualisht paguan 95% të faturave.

Filiali i KESH-it nuk ka ndrojtje as nga Këshilli i Bashkisë, as nga institucione të tjera që duhet të mbronin të drejtat tona nga verbëria që e ka emrin KESH. Mos vallë me këtë qëndrim synohet zbrazja e Beratit nga qytetarët e tij?

Kjo sjellje e KESH-it në Berat e ka emrin racizëm. Qëndrimi ynë qytetar e ka emrin përulje.

Z.Foto Duka, drejtor i filialit të KESH-it mund të ketë marrë një fletë lavdërimi nga ata që i rrinë sipër për kursim të energjisë elektrike në rajonin e Beratit. Mund të ketë ngritje në përgjegjësi për orët e jetës që na vodhi neve, qytetarëve të Beratit. Ndërkohë që Këshilli i Bashkisë nuk na mbron, institucionet e tjera heshtin, s'na mbetet gjë tjetër si qytetarë të thjeshtë veç të pshurrim kështu publikisht mbi fletëlavdërimin e z.Foto Duka, dhe mbi fletëlavdërimet e KESH-it që i kanë marrë duke na i nxirrë ditët tona.

**Yzedin Hima**

### **Çfarë bëhet në selinë e degës së PD (r)-së në Berat?**

Mësohet se strukturat drejtuese të Degës së Partisë Demokratike të Re Berat, janë duke u dhënë dorën e fundit kandi-daturave për bashki e komuna. Ndonëse janë në fazën e listimit, çdo kandidaturë po analizohet jo thjesht mbi bazën e emrit, integritetit e reputacionit, por dhe të platformës konkrete që paraqet, platforma që janë në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe shqetë-simeve të komu-niteteve. Ndër devizat e tyre kryesore është "Për një Berat evropian", sepse pa kornizën e këtij vizioni shumë energji mund të shkojnë kot. Kështu ndër kandidaturat për kryetar bashkie në Berat figurojnë Yzedin Hima, kryetar i degës së PD (r)-së Berat, Simon Vrusho, sekretari Nexhmedin Musai, piktor i njohur restauratori i pikturës së traditës, nismëtar i degës së Partisë, intelektual me reputacion, koherencë e integritet moral; Robert Kosova, matematikan e poet, njohës i shumë gjuhëve:anglisht, italisht, frëngjisht, greqisht, rusisht etj, intelektual energjik, me ide, koncepte e projekte të dobishme për qytetin. Ndërkohë jo më pak të vlerësuar janë edhe kandidaturat e tjera për kryetar komune, si dhe këshilltarët bashkiakë e komunarë.

### **"Lajmëtari"**

#### **Jemi të gatshëm për koalicion me PS-në**

Flet z.Irakli Gjika, kryetar i degës së Partisë Demokratice Sociale.

Partia Demokratice Sociale është një formacion politik i spektrit të qendrës së majtë. Si e tillë ajo, parimisht dhe për përafri programore, natyrshëm në prag-fushatën e zgjedhjeve vendore është e gatshme të hyjë në një koalicion me Partinë Socialiste, në rast se edhe kjo parti e konsideron këtë koalicion në pozita partnerësh realë.

Megjithatë, deri në çastin që po bëjmë fjalë, nuk mund të deklarojmë asnjë akord të arritur ndërmjet degës së PDS Berat dhe asaj të PS. Nga ana jonë ka shkuar propozimi konkret në qendër duke kërkuar njëkohësisht edhe mbështetjen e degës së PS-së për kandidatin tonë për kryetar komune në një nga dhjetë komunat e rrethit, duke i siguruar mbështetjen tonë në nëntë komuna dhe dy bashkitë e tjera. Përsa i përket këshilltarëve,

subjekti ynë do të hyjë veçmas në garë, pavarësisht nga marrë-veshja e mundshme për kryetar komune apo bashkie. Vlen për të shënuar se ndërmjet dy partive tona është bërë një takim paraprak në rang kryetarësh partie, por jo protokollar. Nëqoftëse do të vlerësonim rezultatet e këtij takimi nuk mund të konfirmojmë arritjen e ndonjë marrëveshjeje. Nga sa dimë, e njëjta situatë është edhe ndërmjet partive tona në qendër. Është pozicioni ynë politik që na lejon të jemi të hapur për negociata në rast se edhe nga partnerët tanë lokalë do të shfaqet i njëjti vullnet politik dhe koha në dispozicion, megjithëse është e shkurtër, është njëkohësisht e mjaft-ueshme.

### **Beratasit në thelb janë liberalë, ndaj do të votojnë për ne**

Berati, si jë qytet i dalluar që nga thelbësitë e shekujve për tolerancë dhe liberalizëm, duhet të japë mesazhe të qarta të mendimit dhe të veprimit qytetar. Për Beratin si qytet dhe beratasin si krijues dhe zhvillues të tij është folur shumë. Kjo fushatë elektorale duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet këtij qytetërimi. Para qytetarit beratas shtrohet pyetja: "A është i kënaqur ai me veprimtarinë e pushteti lokal gjatë këtyre tre viteve? Para se t'i japë përgjigje kësaj pyetjeje, do të analizojse çfarë është bërë dhe çfarë i ka munguar atij dhe komuniteti. Mungesat janë të dukshme, të prekshme, të përditshme. Ky realitet do përgjigjen me votën e qytetarit. Ai duhet të mendohet shumë thellë para se ta hedhë votën për forcën politike apo individin që do të realizojë aspiratat e tij gjatë kësaj legjislatore. Partia Bashkimi Liberal Shqiptar është një model shumë i mirë që duhet ndjekur. Kjo parti ka në themel të programit të saj rritjen ekonomike dhe mirëqenien e gjithë popullit. Liberalët janë modeli më i mirë në drejtimin e pushteti. Mjafton të përmendim Japoninë e begatë, ku liberalët drejtojnë qeverinë prej shumë vitesh. Në Shqipëri, model për t'u ndjekur, janë dy liderët e kësaj partie, Teodor Laço e Arian Starova, personalitete të shekncës dhe të kulturës, që kanë drejtuar me kompetencë dy nga ministrinë kryesore: Ministrinë e Jashtme dhe atë të Kulturës.

Këto figura kanë nderuar kombin me punën dhe pastërtinë e figurës morale të tyre. A ka ndonjë rast gjatë këtyre viteve që të flitet apo shkruhet ndonjë rresht për paaftësi apo korrupsion për ata? Këtu duhet të kemi parasysh se në Shqipëri është më lehtë të hedhësh baltë mbi kundërshtarin politik sesa ta pastrosh atë ose t'i japësh atë që i takon. (Çezarit jepi atë që i takon Çezarit). Duke qenë një parti me vlera, në këto zgjedhje, kjo parti do të vendosë kandidatët e saj në të gjitha bashkitë dhe komunat e Shqipërisë, kuptohet edhe në qarkun e Beratit në aleancë me PD. Partia Bashkimi Liberal fushatën e saj do ta bëjë sipas modelit bashkëkohor evropian dhe do të luftojë që tre vitet e rënduara, të egra, të ftohta, në errësirë dhe plot etje, të mos pësëriten më. Këto tri vite të fukarallëkut të përgjithshëm, të politikave denigruese, përçarëse, armiqësore midis njerëzve të një gjaku dhe të një gjuhe, të mbyllen nëpër kasaforta, për të mbetur një model i keq i së kaluarës Duke qenë se liberalët dallohen për realizëm, ne nuk mohojmë dhe arritjet fragmentare. Si bir i këtij qyteti të lashtë, do të dëshiroja që në këtë fushatë elektorale të shpalosen vlerat e vërteta të qytetërimin beratas, vlera që të imponojnë respekt. Në këtë kuadër, do të ishte në nderin e të gjithë qytetarëve beratas të rikujtoja çka thënë ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Haver Peres De kuellar për Beratin : "Berati është një qytet i mrekullueshëm që i takon njerëzimit". Qytetarët e këtij qyteti, në thelb liberal, do të dinë se si të votojnë

**Sami Starova**  
**Kryetar i PBL, dega Berat**

### **MEDIAKAFE...**

Të gjithë kalimtarët mbanin paksa këmbët dhe vështronin gjithëçudi një burrë që jepte e merrte me platformën bosh, ku dikur ngrihej monumenti i diktatorit Stalin. Bënte ca lëvizje të ngathta sikur përkëdhelte erën. Dilte anash, para, prapa. Bënte dy hapa, ulej, ngrihej. Fliste me zë të ulët me dikë që të tjerët nuk e shihnin. Herë pas here fshinte një lot të madh që i rrokullisej tatëpjetë faqes.

"Zot i madh, Zot i madh!" , pëshpërit Mimi duke bërë kryq.

"Të bëj Mimi një pyetje?"- iu drejtua reporterës së gazetë sonë që rastësisht po kalonte anej . " E njeh atë burrin atje?"

"Është Sulua i shekullit, i tha reporterja jonë. " Që kur shpëtoi kot nga ai monstra i Bistovicës e përfytyron veten të derdhur në bronx në vend të Stalinit, si dëshmor martir i fjalës së lirë".

"Jezu Krisht, na mbro!", u lut Mimi duke bërë kryq.

"Hej- drej o punë? Këta kinezët pasi pushtuan rrugën e Dibrës në Tiranë, tani po pushtojnë edhe Beratin. Pa shih, pa shih? Nuk dinë të shëtisin apo të ecin normalisht, vetëm vrapojnë. Si nuk ndesha një kinez që të ecte si të gjithë ne. Hapat vërtetë i kanë të vegjël, por i kanë të shpejtë!, po i thoshte reporteri i gazetës "Koha jonë", kamarieres që erdhi t'i merrte lekët e kafesë.

"Ku e ke kinezin- e pyeti kamarierja dhe hodhi sytë nga sheshi i madh i qytetit nga tregonte dora e reporterit. "Ja! nuk e shikon se si po vrapon drejt Bashkisë?"- iu përgjigj reporteri i të përditshmes. Kamarierja buzëqeshi dh iu kthye:

"Kërkoji Nikoll Lesit urgjent një palë syze se ia more më qafë gazetën me miopinë tënde. Po ai është Kadriu, mor qyq, Kadriu i kulturës ... "Reporterit fshiu sytë disa herë dhe ia nguli sytë shpinës së kalimtarit. "Mos vafsha gjallë në shtëpi, mu duk krejt si kinez, nga ata që rrinë atje poshtë te pularia."

Trajneri i njohur i boksit në Berat, zoti Bujar Orizaj çdo ditë herët në mëngjes del tek agjensia e autobuzave të linjave të largëta dhe të afërta. Në dorë mban një çantë sportive dhe një aparat fotografik digital.

-Për ku je sot, Bujar” -e pyeti një tifoz i çmendur boksi.

-Oh, sot ke shansin për të parë ndeshjen më të madhe të vitit. Do t’ia kalojë edhe ndeshjes së Vlorës. Ndaj merr me vete ca lekë për autobuzin dhe bukë si zakonisht me domate pa djathë- ia ktheu ish boksieri i shquar.

-Po ti ku e ke bukën me domate?

-Unë jam me dietë nga klubi shumësportësh i Beratit iu përgjigj treneri.- Jam në kërkim e zbulim të talenteve të reja në boks për të plotësuar tërë peshat e klubit “Tomori”,

-Ku do vemë sot, mjeshër? -pyeti tifoz.

-Sot zgjidhet kandidati për kryetar komune në Poshnje nga PS e PAA. Do të ketë një rrahje spektakolare dhe 1-2 talente për klubin tonë në sportin e boksit - ia ktheu Bujari.

---

## PD dhe PS ulen në start

Partia Demokratike dhe Partia Socialiste qartësojnë kandidatët e tyre për kryetar të Bashkisë së Beratit. Ata janë:

Dr. **Mehmet Xheka** i Partisë Demokratike (nga burime jozyrtare) dhe z. **Fadil Nasufi** i Partisë Socialiste.

Vija e bardhë e startit pret kandidatët e partive të tjera, të cilët ende nuk janë përcaktuar.

### Lajmëtari

#### Gjërimi i hiçsisë intelektuale

Para do kohësh këshilli bashkiak ka dorovitur dhe iu ka dhënë me bujari titullin “intelektual i shquar i qytetit” dyjarëve Xhovan Dyshniku dhe Miltiadh Bode. Ndonëse kanë kaluar shumë kohë, shtrati i përgjakur që polli këtë togfjalësh të gjatë e plogët si një askarid zorrësh, vroneps dhe kutërbon akoma, sa të duhet të zesh hundët e shpirtit me dorë.

Duke vepruar kështoj synohet të krijohet një mit. Miti i njeriut që s’ka bërë kurrgjë dhe, ndërkohë, i falin një kopësht me dafina. Në këtë vend ku sundon tarafi dhe klani kështu është vepruar gjithmonë: dordolecëve qesharakë që s’kanë funksion tjetër përpos atij për të trembur sorrat u veshin rroba të reja që të ngjajnë si burra shteti; sajohen për ta festa e gosti të buhishme, ku të ftuarit mëtojnë t’i dëndin me llomka të allçinjta lavdie, të gatuar në ca sahanë partiakë të pakailisur, që kanë ngjyrën jeshile të helmit. Mirëpo stomaku ynë e ka të vështirë t’i pranojë e t’i tresë llomka të tilla. Së pari sepse mitet janë veçori e popujve primitivë, të mësuar me idhujtari dhe idolatri. Veç kësaj na ka lodhur së tepërmi simbolika e hatashme e lisave që nga brenda rezultojnë të zbrazët e kufko.

Fjala “intelektual” është një fjalë me semantikë të lëvizëshme e të paqëndrueshme. Ja ç’thotë për këtë Roland Barthesi: “ Intelektuali është bërlloku i shoqërisë. Bërllok në kuptimin strikt, në kuptimin ekzakt, d.m.th që nuk shërben për asgjë, që, të paktën nuk mund të rikuperohet. Çdo regjim i fortë mëton ta vendosë në rresht; reziku i tij është rendi simbolik”. Kurse Foucault: “Intelektualët, nëse kjo racë ekziston akoma, duhet të heqin dorë nga roli profetik”. Është një semantikë negative.

Por Shqipëria ka semantikën e saj të kopesë dhe s’do t’ia dijë çfarë bëhet jashtë vathës së saj të lumtur delërore. “Ehuuu, thonë xhagajdhurët e provincës: bota ka kutin e saj, ne kemi tonin. Ç’na duhet ne me të tjerët, mirë jemi kështu!”. Dhe mblidhen e qerthullohen në qoshet e atij vendi që e quajnë atdhe. Këtë filozofi të veçimit e pamë fare mirë në çfarë derexheje na katandisi gjatë viteve të komunizmit. Duhet të na rënqethet mishi kur të kujtojmë se mund të ringjallet prapë. Kështu i shpërdorojmë dhe simbolet. Sikur fjalët të kishin fatkeqësinë të trajtoheshin konkretisht, fjala, “intelektual” do të shfaqej e fërtelosur dhe shkalifutur, e varur diku në ndonjë pemë afër bashkisë, e mëtuar të rrokët nga çdo vdekëtar i rëndomtë, apo nëpunës ordiner. Gjynah nga zoti, por revista amerikane “Partisan Reveië”, botim i vitit ’92 quan intelektualë të shekullit të XIX vetëm Marks, Hegelin e Niçen. Për Xhovan Dyshnikun dhe Miltiadh Boden s’iu ka vajtur mendja akoma. Çështja e intelektualit dhe e shkrimtarit është një çështje e ftilluar dhe e trajtuar aq shumë sa, ta hajë dreqi, s’ke si të mos kesh ca dromca dijenish. Për të ka folur Haveli, Miloszi, Belloë, Brodsky dhe mjaft të tjerë. Ja ç’thotë ky i fundit: “Intelektuali është një njeri sistematik. Ai përpiqet t’iu japë një sistem, apo antisistem, të krijuar si një përpjekje e vullnetit”.

Si nga shembujt e sjellë më lart, por dhe nga të tjerë që mund të gjenden me lehtësi, shihet fare ashqare se intelektual, pavarësisht semantikës së lëvizëshme, është gjallesa që e vret lart, që ushqehet me ambrozë dhe rri atje ku e kanë vendin perënditë: në Olimp. Kurse të dy rishtarëve tanë, iu merren mendtë sapo ngrenë kokën lart për të parë Olimpin dhe iu rrëzohen kapelet nga koka. Dhe, ta hajë dreqi, Olimpi është aq i rrëpirtë dhe i thepisur, saqë dy të doroviturve do t’iu merrej fryma që në hapat e parë, sepse s’kanë aftësinë për punë të tilla të pavdekshme.

Por le ta lemë Olimpian dhe të zbresim në kodrinë më pak kalamendëse. Në mjediset tona të kafeneve kulturore quhet intelektual gjallesa që, së paku, ka bërë disa vepra, apo qoftë dhe disa shkrime të natyrave të ndryshme. Të dy zotërinjtë e sipërpërmendur jo vetëm që s'kanë vepra, por edhe në ka tek-tuk ndonjë shkrim, ai është në dëm të tyre: një gjuhë belbace, e vobektë dhe karkacule, një stil administrativo-burokratik dhe më së shumti ideologjik. Shkrimthe në shërbim të diktaturës. Duhet të na vijë turp, ose, së paku, të pendohemi për shkrime të tilla. A mos vallë duke shpërndarë këta tituj zavallët e gjerë i bëjnë karshillëk Pluralizmit dhe rivlerësojnë Diktaturën? Atë që dhe vetë Enveri do të nguronte ta bënte, e bëjnë puthadorët e tij qesharakë nën moton: "ishim, jemi, do të jemi, tani e në jetë të jetëve. Amin!...". Kjo do të ishte turpi dhe faqja e zezë, sepse do të shpjegonte fare qashtër pamundësinë për t'u shkëputur nga moçali ku kemi rënë, do të shpjegonte përse estetizohen aq shumë tek ne bazhgaret dhe plehu.

Atëhere cili është motivi për të dhënë tituj të tillë? (Mbiemri Bode, që don të thotë Koka, s'përbën argument të shëndoshë për këtë rast). Orvatja për ta paraqitur çdo kakërdhi miu si një kodër ngashënjyese ku hungërijnë luanë është paranojake dhe qesharake. Rrekem të besoj se është një lloj mëndjelehtësie, një lloj havardallëku anadollak që shkretën dhe barazon si në yrt ulëritës të gjitha vlerat. Ja le të mendojmë se këtë titull e merr (në mos e ka marrë) dhe Vexhi Buharaja. A mund të barabitet puna e tij me atë të Xhovan Dyshnikut që ka ditur të bëjë kalupi të tëra me raporte të thata administrative?.

Së fundi duhet t'iu kërkoj falje të dy personave në fjalë se s'është faji im që iu ra në hise t'iu përmend emrat në këtë shkrim; mbase s'është as faji i tyre, sepse, ku ta dish, as vetë atyre s'iu kishte shkuar në fiqir për hynere të tilla. Dhe të ndërmendim se intelektual s'të bën dot as një dekret bashkiak, ministror, apo presidencial. Intelektuali ka në kokë mëndjen e vet, mbi supe ka dorën e Fatit, kurse si ferman ka vulat e Zotit...

BALIL GJINI

## ÇFARË HARROJMË?...

Ka një traditë të vjetër të paverifikueshme në historinë e mjekësisë Perendimore që i atribuon Erasistratusit, mjekut të famshëm të Aleksandrisë, një gjetje të rëndësishme ose siç quhet sot 'shenje diagnostikuese'. Behet fjale për pulsën. Erasistratusi ishte i pari që kuptoi se pulsi dhe dashuria rrahin, si të thuash, në unison.

Si ndodhi kjo? Një princ i ri, Antiokusi, kishte rënë cmendurisht në dashuri me njerëz, gruan e të atit, mbretin, Stratonicen. Duke e ditur se kjo ndjenje ishte sa e turpshme aq edhe e paligjshme, ai u perpoq ta shtypte pasionin mekatarrë. Me në fund, i brerë nga ndergjegjia dhe i torturuar prej ndjenjës pervelonjese, vendosi të vdiste duke refuzuar ushqimin. Fuqitë zune ta linin, gjalleria dhe lëngu i trupit po shteronin, por sëmundjen asnjë s'po e vinte re. U thirr për konsultë Erasistratusi i famshëm dhe ai vuri re se sa here Stratonica hynte në dhomën e të semurit, ai binte për e turbullimeve psikologjike: djaloshi shpërthente në djerse, zeri i mekej, duart i dridheshin dhe fytyra i skuqej. Me të dukshme ishin ndryshimet në rrahjet e pulsit, të cilat, here shtoheshin e here dobësoheshin. Erasistratusi e rafinoi diagnozën duke i meshuar asaj që është bërë test i detyrueshëm në investigimet klinike: kur shkaku i çrregullimit largohet, pacienti përmirësohet, kur qëllimisht pacienti ekspozohet ndaj shkakut, simptomat rikthehen. Sa here babai i Antiokusit, Seleucos, ose çdo grua e ndryshme nga Stratonica, shfaqeshin në dhomë, asnjëherë nuk riprodhohej simptomologjia. Sapo u sigurua, klinikisti i mencur ishte gati t'i shpallte gjetjet e tij. Ai e beri këtë pasi kishte parashikuar edhe një trajtim për sëmundjen, në mund të quhet e tillë. Hoqi mbretin Seleukos menjëherë dhe i tha se sëmundja ishte pa shërim. S'behej gjë, sepse princi Antiokus kishte rënë dëshpërueshëm në dashuri me gruan e vete Erasistratusit. Me të degjuar lajmin befasisht, babai iu lut që t'ia sillte gruan të birit, me qëllim që ajo të behej ilaci i tij. -Cdo të beje po të ishte në vendin tim-u pergjigj mjeku i mprehtë- do të të duhej të zgjidhje midis burrit të cnderuar dhe profesionistit?!

Me lot në sy e zemer të brengosur, mbreti iu pergjigj se ruajtja e jetës ishte detyra më e lartë, sidomos për një mjek. E, me lutje patetike, ai shtoi se asnjë masë nuk do t'i dukej cnderuese, mjafton që ajo t'i shpetonte të birin. Në këtë rast Erasistratusi iu pergjigj:

-Në këtë rast ilaci është teresisht në duart tuaja! Ti je burri, babai dhe mbreti dhe vërtet mund të jesh mjeku i duhur për familjen tënde.

Vetëm një fjale iu tha të mencurit! Seleukos kuptoi gjithçka, mblodhi asamblenë dhe shpalli se këtë e tutje ai caktonte të birin, Antiokusin, si mbret të Azisë së Eperme, me Stratonicen si mbretëreshë. Përse e tregova këtë histori? Për disa arsye: Se pari, asnjë bir nuk do të kishte sot kaq skrupuj sa të ndrydhte, të shtypte, dashuri të paligjshme ose të turpshme. Se dyti, asnjë baba s'do të tregojë kaq tolerant në "cnderimin" e tij, edhe pse mund të pretendonte se e do të birin me shumë se çdo gjë në botë. Histori të tilla, sigurisht tingellojnë jashtë kohe sot, por mesazhi i tyre mbetet me se bashkëkohor. Ato na mesojnë dicka shumë të rëndësishme: si të dashurojme. Në nuk dime të dashurojme. Të vetmen mënyrë që dime ta bëjmë mirë është ta tregojmë dashurinë në mënyrë të dhunshme. Në një kopsht femijesh në Amerikë shkojnë edhe femije shqiptare. Sapo shohin femijet shqiptarë, femijet amerikane patakshen. Me të hyrë në kopsht, femijet shqiptarë fillojnë aksionin e të treguarit të dashurisë; i ndukin femijet amerikane nga faqet, i shtyjne për toke, u shkulin leshrat, i vrasin me "shpatat" e sajua, u hipin sipër. Prinderit amerikane ankohen. Duhet dikush t'ju shpjegojë atyre se kjo është dashuri "alla shqiptarce" Sa me shumë të ndukim, sa me shumë të pickojmë, sa me fort të shterngojme, aq më dashuri tregojmë.

Pyetja që vazhdimisht më ka shqetësuar dhe vazhdon të më shqetësojë është: Çfare modelesh po u transmetojmë femijeve? Nëse në, të rriturit, vijmë nga modele të dhunshme dhe, dashje pa dashje, po ua transmetojmë ato edhe

femijeve,si do t'i ndryshojme femijet tane? Per c' modele dashurie flasim, kur qytetaret urrejne e mallkojne shtetin dhe shteti mashtron e dhunon qytetaret,kur femija genjen prindin dhe prindi vret femijen,kur gruaja mashtron burrin dhe burri dhunon gruan,kur vartesi i serviliset bosit dhe bosi poshteron vartetin , kur cdo nate ne ekran na shfaqen politikane- manekine-prinder-modele qe shahen ,fyejne e poshterojne njeri tjetrin,e mund te radhisja plot e plot marredhnie te tilla te shemtuar ,ku gjen gjithcka ,pervec dashurise.C' model prindi te ardhshem po pergatisim? C' model familjeje te ardhshme po gatuajme?Per cfare lloj komunikimi po pergatitemi?

Shoqeria e sotme sa vjen behet me e sofistikuar,materializmi po i ze vendin romantizmit,distancat qe ndanin njerezit po shkurtohen ne menyre drastike nga supersoniket,e-mail-et,fakest,makinerite digitale;transaksione te medha bankare perfundojne me nje te shtypur te butonit, makinat dhe teknologjite moderne po zevendesojne e po hedhin ne rruge qindra njerez,shpejtesia e jetes po behet marramendese. Njerezit vrapojne,rendin ,rendin pas parase,pas asaj te mallkuare e te bekuare pa te cilen s'del dot as nga dera e shtepise. E, ne gjithte kete maratone frymemarrese,ne harrojme nje gje ,ate me kryesoren e me kryesoreve,harrojme te dashurojme,harrojme te dashurojme vete dhe harrojme t'i mesojme femijet se si te dashurojne.Nuk e kam fjalin per dashurine erotike.Flas per dashurine ne sensin e gjere te fjales.Kerkojme te pasurohemi,kur jemi te pasur.Dhe,te jesh i pasur nuk do te thote te kesh,por te japesh.Sa me shume jep,aq me i pasur je.Dhe ajo qe s'mbaron kurre edhe pse e jep ne pambarim eshte dashuria.Te duash do te thote te japesh,te falesh,te kuptosh,te pranosh,te tolerosh,te respektosh,te vleresosh,te cmosh.S'mund te japesh ate qe s'e ke. Hipokriti, genjeshtari, mashtruesi, dhunuesi, poshteruesi s'mund te falin as s'mund te japin dashuri, sepse s'e kane ate. Dashuria nuk u mesohet femijeve, aq me pak me moralizime te thata.Dashuria tregohet,demostrohhet,ne veprimet e perditeshme,ne komunikimin e perhershem ,ne vemendjet e vogla me domethenie te madhe,ne sjelljet, ne bisedat me ta ,ne shqetesimet per ta , ne netet pa gjume,ne ditet e mbushura me merakun per ta,ne respektin per zgjedhjet e tyre,ne keshillat e vlefshme,ne lirine qe u japim,ne pergjegjesite qe kerkojme t'u ngarkojme,ne rendesine qe ata kane per jeten tone. Shpesh kam pyetur veten:kush dhe pse e shpiku dashurine?Me siguri,dikush qe eshte ndjere per vdekje i vetmuar,i harruar, i mjere dhe i braktisur.Nje shoqeri pa dashuri eshte e destinuar te shperbehet,nje komunitet pa dashuri eshte i destinuar te rrenohet,nje femije pa dashuri eshte i denuar te shkatërrohet. Ne dime ta bejme gjithcka mire,ne dime te mashtrojme,te poshterojme,te perbuzim,te fyejme,te paragjykojme e te gjykojme,por harrojme te bejme ate,quintesencen e ekzistences,lengun e jetes, harrojme te dashurojme!

**Fitore Sulejmani**

### **Bardhyl Myftiu**

#### **Opozita e përcarë mbetet opozitë**

Qysh në fillim teza e hedhur për bashkëpunim në këto zgjedhje e PD-së me aleatët e vet dhe me PDr, u duk interesante dhe me vlerë, sepse do të bënte të mundur largimin e PS nga pushteti në zgjedhjet e përgjithshme nga pushteti qendror. Për më tepër ky bashkëpunim ishte një rekomandim i Partive Popullore Evropiane, që së paku PD dhe PDr duhej të bashkëpunonin ngu-shtësisht në këto zgjedhje.

Nga ana e vet PD lëshoi thirrjen për këtë bashkëpunim, duke dalë me kandidatë të përbashkët në gjithë vendin. Nisën bisedimet e para midis PD dhe PDr në rang sekretarësh për të përcaktuar modalitetet e mëtejshme. Nga dita në ditë baza e partisë priste rezultatet për të filluar nga puna. Ndërkohë që po zhvilloheshin këto takime, plasi shërri në PS dhe PD në vend që të intensifikonte bisedimet, nisi gradualisht t'i ftohë e t'i zvarrisë dhe të vërë kushte. Në fillim u tha se për bashkitë e mëdha, kompetencat do t'i kishte qendra, për të tjerat do të bisedohej në rang lokal. Ndërkohë nisën të qarkullonin zëra se partitë e vogla duhej të venin në bisedime me PD si ushtari tek gjenerali. Më vonë Z.Berisha deklaroi se partive të vogla do t'u siguronte, në rast fitore, nënkryetarin e bashkisë. Pra oferta ishte e qartë: PD të ndihmohej të fitonte kryetarin e bashkisë dhe PDr nënkryetarin, i cili do të emërohej nga PD dhe më vonë ai, si i tillë, mund të hiqej me ndonjë pretekst banal. Ky ishte hapi i parë i PD për prishjen e bashkëpunimit me PDr. Pas ca ditësh meqë PD s'po gjente dot kandidatë për Tiranën, megjithë thirrjeve që u bëri Selamit nga Amerika, H.Kosovës dhe E.Lekës, nga shoqëria civile, shpalli në mënyrë të njëanshme z. S.Ngjela kandidat për Tiranën. Në këto kushte PDr shpall Z. F.Xhaferri kandidat për në Durrës. Pa dyshim z.F.Xhaferri është kandidatura më brilante e këtyre zgjedhjeve. Atëherë PD kundërsulmon, duke deklaruar se Tirana, Durrësi e qytete të tjera si këto nuk mund t'i lërë në dorë të të vegjëlve, ata duhet të kënaqen vetëm me nënkryetarin e bashkisë që do të punësojë PD. Kështu që gjithë bashkëpunimi praktikisht është prishur, me gjithë retoriken e B.Topit, i cili përsërit avazin e vjetëruar e qesharak të nënkryetarit të bashkisë.

Personalisht qysh në fillim kam qenë skeptik për këtë bashkëpunim, jo pse nuk dua, porse nuk shoh ndonjë frymë reformatore apo tolerancë të PD së vjetër. Arsyet e këtij skepticizmi do t'i permbledh kështu: së pari PD ka mbetur skllave e militantëve fanatikë e të babëzitur, metodave autoritaiste të z. Berisha në parti, anatemimit dhe debitimit të kundërshtarëve nga rradhët e partisë. Reformat bolshevike të kryera nga PD në pushtet për pronën e tokën, mosmenazhimi i krizës në vitin 1997, humbjen radhazi të disa zgjedhjeve dhe mosdashje e të bërit të një analize të hollë për shkaqet e vërteta dhe shkaktarët e humbjeve. Sepse jo gjithmonë fajtorë janë të tjerët, si pushteti apo komisionet zgjedhore, ku në këto komisione bënë pjesë vetë PD. Në

botën e qytetëruar, një humbje në zgjedhje dhe lideri menjëherë, bënë dorëheqje. Kurse te ne liderët janë bërë të përjetshëm. E keqja më e madhe është se opozita po mësohet me humbjet dhe elektorati i saj, sa vjen dhe largohet, duke u bërë abstenues. Unë jam partizan i bashkëpunimit në rang lokal, pa i marrë dorën qendrës. Mirëpo kjo s' mund të ndodhë sepse partitë janë të ngurta dhe s' marrin parasysh idetë personale. Rasti i volitshëm për rëzimin e PS-së nga kriza që e ka mbërthyer, pakënaqësia masive ndaj qeverisjes së korruptuar është i madh, por opozita nuk që në gjendje ta shfrytëzonte këtë rast, sepse dalja me kandidatë më vete bënë pothuaj të pamundur fitoren në këto zgjedhje.

---

### **Njerëz, hidhni një sy te lista e këshilltarëve!**

Pushteti lokal është, pa dyshim, pushteti që çdo ditë preket nga qytetari. Te tryeza e madhe e këtij pushteti vijnë, kryqëzohen, ndeshen, marrin udhën e zgjidhjes, pengohen mjaft nga problemet tona të përditshme. Aty në mënyrë të kamufluar marrin vulën ligjore edhe interesa individualësh të fuqishme, apo të grupeve të tilla. Kjo tryezë quhet Këshilli i Bashkisë. Aty ulen parlamentarë të zgjedhur me votën e qytetarëve për të qenë veshi i tyre, mendja e tyre, goja e tyre, dora e zgjatur e tyre. Nëse ky këshill, që del nga listat e çdo partive politike, devijon fun-ksionin e mësipërm, atëherë ai është ligjitim.

Nëse ai kthehet në veshin, gojën, dorën e klanit apo të individit të fuqishëm atëherë kjo është një shmangie e rëndë, një deformim i demokracisë, një tradhti ndaj qytetarëve. Nëse veshi shurdhohet, goja kyçet, dora koman-dohet, është e njëjta gjë, demokracia nuk fun-ksionon. Nga përvoja si anëtar i Këshillit të Bashkisë së Beratit për një legjislaturë mund të sjell shembuj domethënës. Një këshilltar i njerës nga partitë më të mëdha, gjatë gjithë legjislaturës si këshilltar nuk artikuloi as edhe një fjali të thjeshtë bie fjala: “Rrugët duhen pastruar” Ai vetëm heshti. Votonte siç votonte përgjegjësi i grupit të tij. Edhe sot jam kurioz të di se ç'ngjyrë ka zëri i tij. Ky birboja ende është drejtor i një prej institucioneve më të rëndësishme në Berat. Pushteti i madh, siç duket, vdes pas të pagojëve, atyre që në vend të trurit kanë një lulëlakër. Ndonjëherë nga lexuesit mund të më korrigjojë me të drejtë,

-I qafsh hallin. Memec, memec po ka vënë miliona.

Ky person është ende këshilltar i kësaj legjislature që po mbaron dhe kam frikë se do të jetë edhe në listën e legjislaturës që po vjen. Si përherë, të pagojët, gojëshqyerit për interesa të vetes apo të klanit, nuk janë vetëm në njërën krah të tryezës. Ata gjenden në çdo grup të dalë nga listat e famshme partiake që ne i kemi votuar dhe do t'i votojmë. Në përgjithësi parlamentarët tanë jaën partiakë të thekur, por nula për profesionet e tyre. Rrallë, tepër rrallë mund të takosh ndonjërin me integritet profesional, moral e pushtetar, apo të nevojshëm për ato karrige të rreshtuara përreth tryezës së pushtetit që po presin të rinovohen.

Partitë politike po hartojnë listat e këshilltarëve. Në krye qëndojnë, si gjithmonë, të njëjtët emra që kanë vegjetuar e ngrohur karrigen për legjislatura të tëra. Që nuk kanë ngritur zërin në mbrojtje të atyre që kanë premtuar në fushatë. Që zbatojnë në mënyrë shembullore qëndrimin: Urtë e butë e plot tiganin (e kanë fjalën për tiganin e tyre, jo atë të qytetarëve, që nuk mbrojnë jo më interesat e qytetarëve, por as ato të programit të partisë së tyre. Që gjatë dhjetë vjetëve kanë ndjekur pikë për pikë devizën: “qengji i urtë pi dy nëna,” pra, edhe PD-në, edhe PS-në njëherësh ose herë njëherën herë tjetrën.

Meqënëse jemi në prag votimi, njerëz të besuar, hidhni një sy tek listat e këshilltarëve; Qofshi të PD-së, qofshi të PS-së. Dhe ngrijeni zërin për ata që nuk kanë asgjë me hallet tuaj, problemet tuaj, interesat tuaja. Nëse nuk ju dëgjojnë, atëherë e keni një shans të madh: votën tuaj më 12 tetor 2003

**Yzedin Hima**

---

**Agim Mehqemeja**

### **Që të jetojmë si njerëz**

S'ka ditë që të mos ndodhë ndonjë aksident, ndonjë krim, ndonjë vetëvrasje, ndonjë vetëhelmim.

Gjithçka na e bën të njohur media.

Këto lajme ne i ndjekim me indiferentizëm. Pa u shqetësuar. Pa e vvarë mendjen.

Më tepër na emocionojnë telenovelat. Ato mezi i presim. Ato na bënë të derdhim ndonjë pikë loti. Të dëgjosh mallkimet tona, kur nuk kemi drita në orën e shfaqies së tyre!

Pse ndodh kështu me ne?

Na janë ndryshkur trurë? Apo kemi mbetur pa tru?

Si përgjigje, po perifrashoj një thënie të Martin Luther Kingut:

Është truri ynë që na ka mësuar të fluturojmë si zogjtë. Të vemë edhe në hënë. Të synojmë edhe përtej saj. Është po ky tru që na ka mësuar që të notojmë si peshqit. Që të vrapojmë me shpejtësinë e zërit. Është po ky tru që na ka mësuar si t'i luftojmë sëmundjet, si ta zgjatim jetën...

Vetëm një gjë nuk na ka mësuar ky truri ynë: si të jetojmë si njerëz.

Ju, ndoshta, do të thoni se truri ynë, që të jetojmë si njerëz, na ka mësuar të nxjerrim ligje.

Sigurisht ligjet i kemi. Po ato janë aq të shumta, sa na ngatërrohen nëpër këmbë dhe më tepër na bëhen pengesë. Se është po ky truri ynë që na ka nxjerrë edhe kundërligjet: si të mos i zbatojmë ato, si të gjejmë ndonjë shteg që të shpëtojmë trafikantin, keqberësin, kriminelin, hajdutin...

Është po ky tru që ka mësuar politikanët si të mashtrojnë popullin, sigurisht nuk janë të gjithë, se mendja e tyre punon për kuletën, për vilat, për të kaluar çdo fundjavë në vendet më të bukura, për...

Është po ky tru që nxit këtë popull t'i presë këta politikanë me duartrokitje, që t'u lutet me përgjërime se ai heq dorë edhe nga dritat, edhe nga uji, edhe nga buka, edhe... vetëm e vetëm që ata t'i shohë të kenë dashuri midis tyre, të mos i shohë kurrë të grinden!

Është po ky tru që para këtyre ferrave, nga shpimi i gjëmbave të tyre, nga dhimbja, të ushqehet me vrer, me urrejtje, me indiferentizëm, sa t'i duket e kotë jeta në këtë botë e ta shikojë kuptimin e saj në ndonjë gotë raki, dhe këtë të marrë veresije, me listë, ose t'i japë fund asaj me një nga ato mënyra të njohura nga filmat ose nga media. Që ta kërkojë të keqen e vet si ajo konia te hëna kur ndriçon me dritë të plotë natën e errët.

E ç' nuk ka bërë ky truri i njeriut!

Po që të jetojmë si njerëz vallë do të shpikë ndonjë gjë të re të panjohur deri më sot?

Ku ta dish?!

Shohim e bëjmë njëherë para se ta gjykojmë.

---

### **Këshilli bashkiak miraton ndërtimin e teleferikut të Goricës**

Do të ndërtohet nga një firmë beratase

Këshilli bashkiak në qytetin e Beratit ka miratuar ditën e enjte, në një mbledhje të radhës, dhënien e një sheshi ndërtimi për teleferikun në lagjen "Goricë". Këshilltarët bashkiakë, të të gjitha forcave politike, kanë votuar një zëri aprovimin e sheshit për ndërtimin e teleferikut që do të lidh qendrën e qytetit me malin Goricë. Ndërsa më pas ishte KRT-ja e qytetit ajo që dha aprovimin e parë për ndërtimin e teleferikut duke kaluar pranë këshillit bashkiak dhënien e sheshit të ndërtimit. Pas shumë diskutimeve nga ana e këshilltarëve u vendos që të aprovohet sheshi i ndërtimit me një sipërfaqe prej rreth 500 metra katrorë. Interesin e parë për ndërtimin e teleferikut e paraqiti Instituti i Studimit dhe Projekteve Pyjore me anë të një projekti që iu paraqit këshilltarëve. Sipas përfaqësuesit të kësaj firme, inxh. Gjergji Kule, për ndërtimin e teleferikut do të bashkëpunojë një firmë private beratase. Sipas Kules ndërtimi i këtij teleferiku do të kushtojë, sipas projektit, rreth 1.2 milionë dollarë. Stacioni i parë i teleferikut do të jetë prapa bibliotekës së qytetit për të mbërritur më pas në malin e Goricës. Gjatësia e këtij teleferiku do të jetë 580 metra dhe lartësia 196 metra, ndërsa vagonët do të transportojnë deri në 30 persona. Ky institut është duke ndërtuar aktualisht teleferikun që do të lidh Tiranën me malin e Dajtit. Teleferiku do të ndërtohet me vetë investimet e firmës, ndërsa më pas do të përcaktohet ndarja e të ardhurave. Ndërtimi i këtij teleferiku ka qenë ëndrra e qytetarëve beratas çka do të ofrojë më tepër vizitorë për në malin e Goricës, por dhe do të shtojë dhe të ardhurat e bashkisë së këtij qyteti.

---

### **Uji i ndotur rrezikon shëndetin e qytetarëve**

Që prej më se një jave banorët e lagjeve Goricë, Çlirim dhe Muzaka kanë parë se uji në çeçmat e tyre është i ndotur. Këtë fakt e konfirmoi madje dhe vetë ndërmarrja e ujësjellësit, duke njoftuar qytetarët nëpërmjet televizionit vendor që uji të konsumohet i ziher. Ndonëse këtë radhë ndërmarrja ka menduar për qytetarët, ky nuk është një fakt i panjohur për ta, pasi sa herë që bie shi, uji vjen i ndotur në banesat e tyre. Ka qenë një defekt në tubacionin e ujësjellësit nga amortizimi i këtij rrjeti çka ka bërë që ditët e fundit të shtohen rastet e të sëmurëve nga sëmundje të ndryshme epidemike. Burime pranë qendrës spitalore në këtë qytet bëjnë të ditur se ditët e fundit ka pasur shumë raste të sëmurësh që janë drejtuar në repartin e urgjencës për të marrë ndihmën e duhur shëndetësore. Po sipas këtyre burimeve, pacientët kanë patur simptoma të njëjta: temperaturë, dhembje barku e të vjella që dyshohet të kenë ardhur si pasojë e konsumimit të ujit të ndotur. Të tjerë banorë të këtyre lagjeve i janë drejtuar dyqaneve më të afërt për të blerë ujë të ambalazhuar, ndonëse diçka e tillë është e papërballueshme për të ardhurat e tyre. Populli nuk është rinjoftuar për ndryshimin e gjendjes.

Eriola Azizolli

## Zjarri shkruan mijëra rrënjë ullinj

Zjarri ka përfshirë mesditën e ditës së premte ullishten e fshatit Poshnje një masiv prej rreth 60 mijë rrënjë. Zjarri i rënë për motive ende të panjohura, ka vazhduar për rreth pesë orë me radhë dhe mësohet të ketë shkruan rreth 15 hektarë me ullinj. Burime nga reparti i zjarrfikses bëjnë të ditur se rreth orës 13:00 është marrë informacioni për rënien e një zjarri në kodrat e mbjella me ullinj në aksin rrugorë Berat-Fier, në vendin e quajtur “Qafa e Sqepurit”. Menjëherë pas marrjes së informacionit, bëjnë të ditur këto burime, mjetet e këtij reparti kanë mbërritur në vendngjarje për të kufizuar në maksimum flakët e zjarrit. Nisur nga shtrirja e fuqishme e zjarrit ndihmuar dhe nga era e pasdites punonjësit e repartit të zjarrfikses e kanë patur të pamundur lokalizimin e flakëve të zjarrit. Kjo ka bërë që në ndihmë të punonjësve të zjarrfikësve të mbërrijnë dhe shumë rekrutë të repartit ushtarak të Poshnjes. Vetëm pas orës 17:00, pas një pune prej pesë orësh është bërë e mundur fikja e këtij zjarri që sipas burimeve të drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit është zjarri që ka shkaktuar më tepër dëme gjatë tre viteve të fundit. Burime nga Prefektura bëjnë të ditur se është ngritur një grup i posaçëm pune me specialitet të këtij institucioni dhe të drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit për të llogaritur dëmet e shkaktuara. Nga ana e tyre fermerët shprehen se zjarri që ka përfshirë pronat e tyre u ka shkaktuar një dëm të pallogaritshëm, pasi ullinjët janë në kulmin e prodhimit. Burime të organit blu në këtë qytet bëjnë të ditur se ka nisur të hetohet mbi rënien e këtij zjarri, flakët e të cilit kanë shperthyer njëherazi në tetë vatra. Po sipas këtyre hetimeve mësohet se policia po punon për identifikimin dhe ndalimin e autorit, pasi, dyshohet, se zjarri është vënë qëllimisht për motive ende të panjohura.

## Asfaltohet një rrugë e re

Vazhdojnë punimet për asfaltimin e rrugës Berat -Përmet në segmentin e Goricë - Drobonik. Vihet re se është duke u punuar me një nivel të lartë cilësor. Deri tani ka përfunduar shtrimi me çakëll, nivelimi, vendosja e kaskadave dhe pusëve në të gjithë segmentin. Kjo rrugë do t'i çojë banorët e qytetit të Beratit në një nga pikat e bukura turistike të pyllit të Drobonikut.

### Nëse nuk na kthehet toka , do ta marrim me forcë

“Nëse nuk do të na kthehet toka, që na takon me ligj, ne do ta marrim atë me forcë,” kështu janë shprehur për gazetën përfaqësuesit dhe pronarët legjitim të tokës së shkollës së mesme “Kristo Isak”. Ishin pikërisht mësuesit e kësaj shkolle që rreth 10 ditë më parë, i dërguan një peticion Kryeministrit Fatos Nano për mosnjohjen e vendimit nr.173, të datës 27.8.2002 të Komisionit të Kthimit të Pronave ish-pronarëve në këtë qark. Ky vendim si dhe dy vendime të gjykatës së Faktit Berat, me nr.1018, dhe të apelit Vlorë, me nr.233, të datës 20.8.2000 dhe 14.5.2003, i japin të drejtë pronarëve për pronën që mban shkolla “Kristo Isak”. Toka-ekonomi e kësaj shkolle ndodhet brenda territorit përfshirë në studimin e ri të KRTSH-së, duke u miratuar si truall ndërtimi për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit, prej 72 ha, si dhe studimin urbanistik pjesor të kësaj zone. Me zgjerimin e kësaj vije, shprehen pronarët, na lindi e drejta sipas ligjit që pronën e marrë dikur nga shteti, të na e kthejë. Burime nga zyra e kthimit të pronave dhe kompensimit bëjnë të ditur se sipërfaqja e futur brenda vijës kufizuese prej 79 ha automatikisht duhet t'i kthehet ish-pronarëve. “Në rast se shkollës i nevojitet toka, - shprehet një prej pronarëve, Nexhi Pilafi, -për këtë le të mendojë bashkia e qytetit duke u dhënë prona të tjera shtetërore dhe jo të mbajë peng pronat tona”.Nëse kjo pronë nuk na kthet shprehen pronarët nëse do të marrin atë me forcë duke përdorur vendimet e marra nga KKRT-ja e rrethit.

### Mbytet në lumë duke u larë 18-vjeçari

Ka gjetur vdekjen, ndërsa lahej në ujërat e lumit, Osum, një 18-vjeçar, banues në lagjen Kala të këtij qyteti. Burime të organit blu bëjnë të ditur se rreth orës 16.30 të ditës së enjte ka gjetur vdekjen duke u mbytur në lum 18-vjeçari Gentian Dauti. Adoleshenti mësohet se ndodhej në lum me shokët e tij për t'u freskuar gjatë orëve të mesditës në lagjen “30 -Vjetori”, por ka mbërritur i vdekur në shtëpinë e tij në lagjen Kala. Shokët me të cilët shoqërohej 18-vjeçari mësohet të jenë shprehur se gjithçka ka rrjedhur normalisht deri në orën 16.00. Ata kishin vendosur të laheshin për herë të fundit në ujin e lumit Osum, duke u zhytur njëri pas tjetrit. Kanë mjaftuar pak minuta që shokët të kuptojnë se 18-vjeçari Dauti nuk kishte dalë në sipërfaqe të ujit. Fillimisht të gjithë kanë menduar për ndonjë shaka të adoleshentit, po, kur kanë parë se ai nuk po dilte mbi ujë, janë zhytur për ta nxjerrë. Ata janë përpjekur t'i ofrojnë ndihmën e parë shokut, por, pasi kanë parë mosreagimin e 18-vjeçarit, janë nisur për në qendrën spitalore për t'i dhënë ndihmën e duhur shëndetësore.

Burime nga reparti i urgjencës pranë qendrës spitalore, bëjnë të ditur se adoleshenti kishte mbërritur i pajetë në spital. Sipas bluzave të bardha ai ka gjetur vdekjen ndoshta në momentin që ka rënë në kontakt me ujin e lumit. Pas mbërritjes në morgun e spitalit, familjarët kanë marrë trupin e pajetë të 18-vjeçarit.

---

### Koncert me muzikë xhaz në Berat

Një koncert i tëri me muzikë xhas ka mbërritur javën e kaluar në qytetin e Beratit për të vazhduar më pas në qytetin e Poliçanit dhe të Kuçovës. Kanë qenë katër muzikantë zviceranë që me anë të një projekti muzikor që ka përfshirë Zvicrën, Italinë, kanë ardhur në Berat, kanë zhvilluar tri koncerte të suksesshme. Organizuar nga Qendra e Kulturës, grupi “Direcione sud” ka zhvilluar ditën e mërkurë në qendrën e qytetit koncertin e parë me muzikë xhas për të vazhduar më pas në qytetet e tjera me dy koncerte të suksesshme. Projekti muzikor “Direcione Sud” ka lindur nga mendimi i katër muzikantëve pjesëtarë të grupit, që kanë zgjedhur nga Shqipëria qytetin e Beratit për të zhvilluar koncertin e tyre që ka përshkruar një bosht simbolik nga veriu drejt jugut. Ky kuartet muzikor është i përbërë nga katër artistë që kanë zgjedhur nga dëshira qytetin e Beratit për ta bërë pjesë të projektit të tyre. Këta artistë të lidhur ngushtë me muzikën xhas dhe me anë të improvizuar kanë si qëllim artistik për të paraqitur përmes kompo-zimeve vetjake një muzikë të pasur. Qytetarët beratas kanë ndjekur nga afër shumë pjesë muzikore xhas të kompozuar nga muzikantët e këtij grupi, një pjesë e të cilave janë të improvizuara.

---

Luan Myftiu Tregim

### Brenga

Kishte net që nga dritarja hynte në dhomën time një flutur. Një nga ato fluturat e natës, për të cilat disa thonë se janë shpirtra njerëzish. Nga mënyra e qetë e përplasjes së krahëve dhe ngulmimi për të mos qëndruar një çast pa fluturuar, nuk di pse më kujtoi motrën tonë, e cila po mbushte vitin që ishte larguar nga kjo botë. Ndoshta kjo më shtyu të shkoja të nesërmen në varrezë e t’i vija asaj një lule te koka. Ndoshta edhe të shkëmbeja ndonjë fjalë me fotografinë, e cila, siç më qe dukur herët e tjera, na e tregonte motrën si një engjëll që digej nga dëshira për të ditur se si na shkonte tani jeta. Dhe, ndonëse atë ditë binte një shi i rrëmbyer, u gjenda atje para portretit të saj, gjithmonë të qeshur, fiksuar në qelq dhe vendosur me kujdes në mermerin e bardhë. Si për çudi, nisa të dëgjoj befas aty, krejt të mallëngjyer, zërin e saj, i cili po i ngjante atij të një fëmije, që porsa zgjohet nga gjumi dhe kërkon me sy të jëmën.

“Çdeshe sot këtu, në këtë kiamet, të keqen motra? Fshiji piklat e ujit, se po më dukesh sikur qan. Nuk ke marrë shami me vete? ... Apo po qan vërtet? Të lutem mos! Nuk të paskan lezet lotët! Se mos vajton duke u kujtuar se unë jam larguar e mërzitur nga ju? Se mos më ka mbetur hatri nga ndonjë sjellje e pakujdesshme ndaj meje? Mos u ligështu kështu, të lutem! Ç’ e ke atë send në dorë? Lule? Rrofsh, vëlla Po më mirë të ma sillje ndonjë ditë me mot të kthjellët. Shih si qenke lagur! Si të qenkan bërë këpucët tërë baltë! Fshiji këtu, tek bari që ka mbirë rreth meje. Fshiji pa merak, se barin mua ma lan shiu! Dale?... Po psherëtin?... Se mos ke ardhur për të qetësuar ndonjë brengë?! Jo, vëlla, mos u mërzit! Jeta kështu është bërë! Të gjithë kanë nga një brengë. Ja dhe unë, që e mbylla hesapin tim, përsëri kam brengë. njerëzit nuk janë shenjtorë, vëlla! Edhe unë e pyes shpesh veten: mos vallë u largova më herët se sa duhej? Mos lashë diçka pa kryer nga detyrat e mia? Nga detyrat e mia ndaj jush? Falmëni, nëse ju duhesha ende! Po unë, a nuk e kam brengë, që s’ e shpura dot deri në fund atë përgjegjësi, që e mora përsipër qysh e vogël? A të kujtohen ditët kur na arrestuan babanë dhe na rrëmbyen nënën, e çmendur prej tyre? Unë e gjora u përpoqa që ata të ktheheshin gjallë ndonjë ditë në shtëpi, por nuk qe e thënë, ose, më mirë të themi, komunistët nuk deshën që ata të dilnin prej andej, nga frika se mos i tregonin botës tmerret që kishin përjetuar në atë ferr. Por ne, vëlla, më duket sikur e kryem detyrën. A nuk e shitëm për ta shtëpinë? Për ta a nuk shitëm dhe jorganët? Unazat dhe vathët e nënës? Ç’ na mbeti tjetër kujtim prej saj? A nuk i gdhimë netët e ftohta pa zjarr, që të kursenim për t’i blerë fanella babait? Lavdi Zotit që nuk u bëmë lypsarë!...”

Ndërsa motra më fliste atje që nga mermeri, m’u kujtuan çastet kur komunistët, pasi i vunë nënës sonë hekurat në duar, na flakën në qilarin e shtëpisë dhe na kërcënuan për të na detyruar të mos qanim me zë. M’u kujtua se si motra doli nga “fregjia” e qilarit dhe, duke vrapuar drejt nënës, u briti policëve: “Mos na e merrni! Mos na e merrni nënën tonë! Jemi të vegjël dhe unë nuk di as të gatuaj, as të laj teshat! ...”

Por policët nuk i kthyen kokat pas. A thua të kenë patur frikë se mos prekeshin duke na lënë jetimë me të dy prindërit gjallë?

Dhe, ndërsa kujtimet rridhnin brenda meje si ai gruri në mëngër, guxova një çast të ngre kokën e të shihja në fotografi motrën, e cila sa vinte e dukej më e dhembshur e më e qeshur, duke larguar nga fytyra e saj edhe atë

hijen burrërore që ia dhanë hallet, të cilat i ranë qysh në moshën 13-vjeçare. Tani nuk ishte më ajo miturakja që u bë për ne nënë e baba. As ajo shtegtarja që mbeti tërë jetën rrugëve duke vrapuar, sa në burgun e Burrelit, ku dergjej pa faj babai ynë, në dyert e psikiatrive të Shqipërisë për ta bërë nënën tonë të ngjitej nga errësira e vetëdijes së saj deri në kujtimin se dikur kishte patur edhe fëmijë. Nuk ishte më ajo vogëlushja që dikur qante me zë, kur i digjej fundi i kuisë së harruar në zjarr, ku kishte vënë për të larë teshat tona. Nuk ngjante tani motra as me atë punëtoren me gishtat e enjtur nga pesha e dhjetëra tezgave me gurë për të mbajtur me bukë veten dhe ne jetimët e tjerë, që na dërgonte në shkollë si për të kryer detyrën e një prindi të etur për dituri. Çuditërisht sot këtu, te qoshja e varrit të saj: kush e mësoi këtë martire të vetëflijohes për ne? Por ajo, si t'ia lexonte mendimet e mia, nisi të flasë. Foli? Si foli? Jo! Jo! Nuk qe zëri i saj! Ishte era që lëvizti degët e një qiparizi. Apo mos klithi ndonjë zog nga gëzimi që qielli u hap dhe dielli nxori synë?

“Mos, të keqen motra, mos e mendo veten! Mos jeto me brenga! Se vetëm dhembshuritë e vërteta prodhojnë brenga! Se unë kurrë, vëlla, nuk jam munduar nga dëshira që të tjerët të vuajnë për mua. Qoftë edhe për të më dashur më shumë. Se mos e patët fajin ju që mua më takoi kjo barrë pak më e rëndë? Kështu rodhën punët dhe unë s'bëra veçse detyrën. Kam vetëm një merak: mos vallë duke u kujdesur si prind ju shkaktova ndonjë keqardhje të fshehtë, të cilën nuk ia thoshit as vetes? Keqardhje për sakrifikimin tim? Po ti, të paktën, duhet ta kesh kuptuar sa e lumtur kam qenë, o vëlla, te ju shihja që përparoni në jetë. Apo ndoshta edhe sot nuk e merr dot me mend se ç'forcë ka dashuria e një motre? Sidomos ajo e një motre për vëllezërit jetimë? Më falni, nëse ju kam ligështuar duke u kujdesur për ju më tepër ndoshta se sa ju nevojitej. Por ju betohem që kam qenë e lumtur. Pastaj m'u bë dhe zakoni kujdesi për ju. E beson që kishte raste që ju më dukeshit si fëmijët e mi?! ... O Zot!! Asgjë nuk le pa kompensuar! Edhe nga mjerimi na bën të nxjerrim gëzime! Të lutem, vëlla, mos u ligështoj! Mos mendo se jam pishman që bëra atë jetë me mundime. Sikur të përsëriteshin njëmijë herë ato rrethana, unë njëmijë herë atë jetë do të zgjidhja. E ç'bëra unë në fund të fundit? Në kushtet e asaj diktature të egër, unë gjeta një mënyrë për t'ia dhënë një kuptim jetës sime?. Ah, vëlla, sa motra të tjera mbetën pa krijuar familje si unë! E ku na la ne “kuçedra” të mendonim për fatin tonë?! Mos u mërzi, të keqen motra! Se unë gjithë qëndrimet e tua i kam kuptuar. Kështu ndodh në mjerim. Njerëzit i pikëllon mendimi se mos janë shkaktarë të vuajtjes së tjetrit. Po dije që unë kam qenë aq krenare për detyrën që mora dhe aq të pavaruar e kam ndier veten, sa më vinte keq te ju shihja të mbanit ndaj meje atë qëndrim disi të ftohtë për të më detyruar të mendoja më shumë për veten. Sa fëmijërore më dukeshin përpjekjet tuaja! Por, kurrë nuk ju lëndova duke u rebeluar edhe kur ndonjë qëndrim juaji më prekte në sedër.

Mbeta i shtangur. Motra nuk kishte folur kurrë kështu. Po më qortonte? Apo duke më treguar gabimet kërkon e gjora të më çlirojë nga ndonjë brengë? Edhe e vdekur mendon për ne? Ç'të qe ky zë? Merak motre që s'e tret dheu? Apo klithmë e ndërgegjes sime, të plagosur nga mungesat e kujdesit tim ndaj një motre që s'i gjendej shoqja? Të rridhnin këto pendesa nga ndonjë mosmirënjohje fyese apo ishte diktatura ajo që na krijoi rrethana të mbanim nga një herë ndaj njëri-tjetrit qëndrime jo të drejta? Po! Po! Ka qenë dhuna e komunizmit burimi kryesor i brengave tona! Lum ata që u ngritën mbi veten dhe fituan betejën më të madhe: nuk i shkarkuan mbi të tjerët mllefet që u mbillte çdo ditë në shpirt mizoria. Na fal, o Zot, në s'kemi mundur të luftonim apatinë e shpirtit, që na krijonte tundimi për ta gëzuar me çdo kusht jetën.

Dhe kështu, mes psherëtimash, ngrita sytë dhe pashë fytyrën e motrës. Pastaj s'di se si, tërë portretin e saj në këmbë para meje. Me sy të përplotur si nga një gëzim i madh. M'u duk fytyra e saj si ajo e një nëne të lumturuar, te sheh fëmijët që japin shenja se do t'ia justifikojnë dashurinë. Dhe u ngrita të largohem, me kokën pas dhe me një betim në zemër se, për sa kohë më kishte mbetur ende për të jetuar, do të bëja çmos të isha i denjë për sakrificën e motrës.

## Rrëfenjëza

Përktheu: Fiqiri Tartari

### Kush nuk lutet

Një fshatar, gjatë një dite pazari u ndal për të ngrënë në një restorant të mbushur me njerëz, ku drekohej zakonisht edhe nga ajka e qytetit. Fshatari gjeti një vend në një tryezë, në të cilën rrinin edhe të tjerë klientë, dhe i bëri kamrierit porosinë e tij.

Kur porosia i erdhi, bashkoi duart dhe recitoi një lutje.

Të pranishmit e vrojtuan me kureshtje.

Me ironi, një i ri e pyeti:

“Në shtëpinë tuaj bëni gjithmonë kështu? Luteni në të vërtetë të gjithë?”

Fshatari, që kishte filluar qetësisht të hante, iu përgjigj:

“Jo, edhe te ne ka ndonjë që nuk lutet”.

I riu u zgërdhi: “ Ah, po. Kush është ai që nuk lutet?”

“Mirë pra”- vazhdoi fshatari, - po jua them: për shembull lopët e mia, gomari im dhe derrat e mi ...

## Tre çibukët

Një plak i ditur indian u jepte këtë këshillë të rinjve të rrëmbyeshëm të fisit të tij:

“Kur je me të vërtetë i zemëruar me ndonjë që të ka ofenduar për vdekje dhe vendos ta vrasësh për të larë turpin, më parë se të nisësh, qëndro, mbush mirë e mirë me duhan një çibuk dhe thithe. Mbaro çibukun e parë, ti do të vësh re se vdekja, si përfundim, është një ndëshkim tepër i rëndë për fajin e kryer. Do të vijë ndërmend, atëherë, të shkosh për t’i dhënë një rrahje vendçe. Para se të kapësh një kopaçe të madhe ulu, mbush një “çibuk të dytë” dhe thithe gjer në fund. Më së fundi do të mendosh se sharjet e forta e të gjata do të mundin shumë mirë të zëvendësonin të rrahurat. Mirë! Kur qëndron për të sharë atë që të ka ofenduar, ulu, “mbush çibukun e tretë”, thithe dhe kur do ta kesh mbaruar, do të kesh vetëm dëshirë që të ripajtohesh me atë person”.

## Kur mbaron nata

Një prift plak pyeti një herë nxënësit e tij se nga ç’gjë mundej të njihje çastin e saktë në të cilën mbaronte nata dhe fillonte dita.

“Ndoshta kur mund të dallosh me lehtësi një qen nga një dele?”

“Jo”, i tha prifti.

“Kur dallohet një pemë hurmash nga një pemë fiqësh?”

“Jo”, përsëriti prifti.

“Por kur dallohet atëherë?”, pyetën nxënësit.

Prifti iu përgjigj:

“Kur duke shikuar fytyrën e një personi të çfarëdoshëm, ti dallon një vëlla ose një motër, gjer në këtë çast është akoma natë në zemrën tënde”.

---

## Ajet Nallbani

### Ndërtimi i puseve dhe i çezmave në qytetin e Beratit

Qysh në kohët më të lashta sigurimi i ujit të pijshëm ishte problemi kryesor në zhvillimin e qyteteve dhe në sigurimin e jetës së garnizoneve në kushte rrethimi.

Gjurmët tregojnë disa mënyra ndërtimi për sigurimin e ujit: sterat, çezmat, puset si dhe burimet natyrore: lumenjtë, përrenjtë etj.

### Sterat

Sterat i gjejmë me përmasa të ndryshme sipas karakterit të përdorimit: të përdorimit vetjak që shërbenin brenda familjes ose të përdorimit kolektiv që janë përdorur nga lagjet ose nga garnizonet e vendosura pranë tyre. Këto furnizohen nga strehët e çative nëpërmjet ullukëve.

Steret me karakter vetjak kanë përmasa të atilla që përballojnë nevojat familjare.

Këto shkojnë rreth 5-6 metër kub, po nuk përjashtohet edhe me përmasa më të mëdha. Sterat kolektive kanë madhësi që shkojnë nga 50-60 metër kub deri 1000-1500 metër kub.

### Puset

Për sigurimin e ujit ka shërbyer dhe ndërtimi i puseve, të cilët gjenden kryesisht në vende me lagështi dhe sidomos në ato fushore, ku uji del në formë burimi. Taknika e ndërtimit të puseve vjen deri në në ditët tona si një trashëgimi e lënë brez pas brezi. Për ndërtimin e puseve mjeshtri duhej të njihje mirë strukturat e tokave që mbajnë ujë. Toka ku do të ndërtohej pusi duhej të kishte lagështi në sipërfaqe ose lagështi të mjaftueshme që në shtresat e para pas gërmimit. Këto ishin vendet e veshura me bimësi, sidomos me vidha dhe kulmak .

Çasti i shfaqjes së ujit ishte kurorëzimi i mundit të specialistëve, të cilët e ruanin këtë rast , se sipas traditës së tyre, nëse do të vërehej së pari nga një tjetër dhe jo nga ai, uji “do të largohej”. Kjo mendësi rëndonte mni ndërtuesit e pusit, të cilët duhej të punonin me ngut derisa të shfaqej uji. Nga puset kolektive përmendim: Pusi i Kozares te Hani i Kozares në lagjen Mangalem. Ishte i thellë 18 pash dhe përmendej për ujin e ftohtë e të lehtë. Pusi i Pazarit të Misrit, Pusi i Kasaphanës, Pusi i Xhamisë Mbret, që përdorej për nevojat e xhamisë dhe të banorëve të lagjes së Sherit. Pusi i Xhamisë së Beqarëve, ishte me çikrik, përdorej për nevojat e xhamisë, të banorëve dhe të dyqanxhinjve. Ky pus kishte ujë të ëmbël, i parapëlqyer për shuarjen e bullutës në masën një me tre, një pije e nxjerr nga alkooli i misrit.

Nga puset me përdorim përdorim vetjak përmendim: Pusi i Bizbiqit, 18 pashë i thellë; Pusi i Shëndëlliut, i ndërtuar në oborrin e kishës, i mbyllur në një godinë të vogël dhe që shërbente vetëm për kishën.

## Çezmat

Vendi më i pasur në burime është zona e Biftës, e cila është mjaft e gjelbëruar. Këtu janë ndërtuar një numër i madh çezmash, një pjesë e të cilave ruhen edhe sot. Këto ndërtoheshin nga individë ose grupe të bashkuar, të cilëve u shërbenin. Këto çazma mbanin emrin e ndërtuesit ose të pronarit të truallit. Të tilla janë: Çezma e Millonait, që gjendet nga ana perëndimore, e rikonstruktuar në vitin 1925, sot gjenden vetëm gjurmët. Çezma e Shëndëlliut në afërsi të kishës, e rikonstruktuar po në vitin 1925. Në afërsi të saj gjendet një çezmë tjetër që mban të njëjtin emër. Të dyja plotësonin nevojat e lagjes Breg. Çezma e Petrakut që gjendet në faqen veriperëndimore, në rrugën që zbrret për në Burdullias. Çezma e Muzhakës ose siç quhet ndryshe dhe e Lenës ose e Veveçkës, sipas emrave të pronarëve të mëparshëm.

Çezma të tjera janë: Çezma e Parangoit, Çezma në Qafën e Tufave në Goricë, Çezma e Qypit (me emrin e familjes), Çezma e Shën Kollit në Goricë, Çezma e Lajthisë, Çezma e Kroit, Çezma e Kapedanit, Çezma e Stosqindit (emër vendi midis Goricës dhe Virjonit), Çezma e Kondasit.

Lagjja Kala, që problem kryesor kishte ujin, i shfrytëzonte dhe i mirëmbante këto çezma. Për këtë qëllim ishte krijuar Shoqëria Mirëbërëse, e cila kishte për qëllim ndërtimin dhe mirëmbajtjen e çezmave të karakterit kolektiv. Kjo shëqëri mirëmbante edhe rrugët e kalimit që të çonin në këto burime ujore. Ajo zgjidhej nga banorët e lagjes. Të ardhurat i siguronte nga kontributi i të gjithëve në periudhën e ullirit dhe të vajit sipas një kuote të caktuar.

## Ujarët

Furnizimi me ujë i lagjes Kala dhe i lagjeve bëhej me ujarë. Kështu quheshin ata që transportonin ujë me kafshë të ngarkuara me bucela druri. Çdo shtëpi kishte bucelat e veta dhe pajtonin ujarë të përhershëm.

Lagjja Mangalem furnizohej me ujë nga pusët që gjendeshin në qendër të qytetit, nga Pusi i Kozares si dhe nga terat që gjendeshin në brendi të shtëpive. Kjo lagje shfrytëzonte dhe burimin te Lundra (vendi ku kalonte lundra që lidhte të dy lagjet). Ky burim ka të njëjtin ujë me pusin e Kozares dhe siç thotë populli, vjen nga i njëjti damar. Nga burimi i Lundrës dhe i Shën Mërisë uji merrej me gjyma duke i mbushur me enë të vogla. Të dyja këto burime sot janë mbuluar nga mbushjet që ka krijuar lumi.

Lagjja Goricë furnizohej nga burimi tek Ura e Goricës, ku mbushnin ujë dhe ujarët, si dhe nga pusët vetjake që gjendeshin kryesisht në rreshtin e parë të banesave, aty ku terreni rrafshohet.

Qendra e qytetit, përveç vendeve të lartpërmendura, furnizohej me ujë dhe nga çezma që populli e ka quajtur Çurku. Kjo kishte ujë të bollshëm dhe të mirë.

Lagjja Muratçelepi është furnizuar me ujë nga pusët vetjake që pothuaj gjendeshin në çdo shtëpi, dhe nga çezma e Sahatit, ujët e së cilës vinte nga burimet e Biftës. Gjurmët e kësaj çezme janë edhe sot në gjendje të rënuar.

Një ujësjellës u ndërtua nga Kurt Pasha, i cili kishte si qëllim të çonte ujin e burimeve të Mbreshtanit në Kala. Këto punime i morën përsipër disa mjeshtrë, të cilët e ndërtuan ujësjellësin me qyngje deri në afërsi të qytetit. Sipas të dhënave gojore, nuk e përmbushën dot detyrën e marrë nga pashai, nga gjendja e rëndë e terrenit, që nuk ishte parashikuar në projekt. Gjurmët e këtij ujësjellësi vijnë deri te vendi i quajtur Sqollë.

## Shkallarja e kalasë

Një objekt tjetër që ka shërbyer për sigurimin me ujë të kalasë së Beratit është dhe rruga që e lidh kështjellën me lumin Osum. Kjo është ndërtuar në shpatin jugor të saj në një terren mjaft të thyer. Pozicioni i vendosjes së kullave ndihmon për vrojtim nga të gjitha anët. Ndërtimi është bërë i gjithë me gurë. Gjatë mureve të trasha janë lënë kamare të vogla të cilat kanë shërbyer si frëngji për t'u mbrojtur si dhe për të lehtësuar komunikimin. Mbulimi i saj është bërë me qemere guri të punuar mirë dhe që vijnë në formë të shkallëzuar në drejtim të pjerrësisë së vendit. Kalimi bëhet në shkallë guri me një gjerësi të atillë që kalokjnë lirisht dy vetë dhe lartësinë sa një bojë njeriu. Po të shetisëh rrugëkalimin, te kulla e parafundit duhet të ndalosh. Ky fund të jep të kuptosh se shkallët këtu përfundojnë dhe fillojnë poshtë saj për t'u bashkuar me kullën tjetër. Ky disnivel krijon vështirësi për t'u ngjitur dhe për të zbritur pa ndihmën e një shkalle portative. Kjo duket se ka qenë dhe zgjidhja e mëparshme. Me heqjen e shkallës portative pengohej kalimi nga poshtë lart për çdo të papritur.

---

Agim Mehqemeja

POETË BERATAS NË SHEKUJ

vijon nga numri i kaluar

## 4. ISMAIL PASHË VELABISHTI

### Shekulli XVIII

Sundoi në Berat në vitet 1750-1764. Synoi ta zhvendoste qendrën e qytetit në Velabisht. U pa për

pak kohë me sy të keq nga Sulltani. E dërguan si mbrojtës të kalasë në Lepante të Greqisë. Lëvroi edhe poezinë. Ishte njeri i librave. Krijoi në pallatin e tij një bibliotekë shumë të pasur me vepra në gjuhët arabe, perse dhe turke. Me vrasjen e tij në vitin 1771, biblioteka iu grabit dhe iu dogj, sepse ishte deklaruar fermanli nga sulltani. Me bibliotekën e tij u dogj ose u grabit edhe krijimtaria e tij poetike. 1)

1. Bardhyli, "Historia e bibliotekave në Shqipëri", në "Hylli i dritës", Shkodër, 1938, faqe 290; Qeramudin Durdia, Agim Mehqemeja, Bedri Telegrafi, "Hapësira të kulturës islame", Berat, 1999, faqe 31.

### MBI KËTË KALA TË SHKRET

... Mbi këtë kala të shkretë  
kush u bë sebeb që na pru,  
belaja krejt mos iu heqtë.

Në këtë poezi, midis të tjerave,  
shprehet malli për  
vendlindjen, shfryhet edhe  
vreri i mbledhur në zemër nga  
largimi i detyruar prej Beratit.

### 5. KOSTANDIN BERATI 1740-1828

#### Përkthyesi më i vjetër në gjuhën shqipe.

U lind dhe jetoi në Berat. La një dorëshkrim me dy fjalorë greqisht-shqip, përkthime nga ungjilli, lutje, një kronikë greqisht mbi ngjarje të viteve 1764-1798 dhe poezinë "Shën Mërija para kryqsë". U përpoq të fuste përdorimin e një alfabeti të veçantë në shkrimin e shqipes. Por kjo përpjekje nuk pati pasues të njohur dhe të peshës së autorëve të letërsisë shqipe me alfabet arab.

#### SHËN MËRIJA PARA KRYQSË

Zonjë Shën Mëri ardhurë,  
e ndenj përpara kryqsë;  
e mbretëreshë engjëjet,  
zonjë e gjithë dynjasë,  
e kur e pa mbërthyerë  
shpëtimnë njerëzisë, 1)  
e qante ngashëryerë,  
me mallënjim thërriste:  
"Iudha i mallëkuarë,  
që kallëzoi çifutë,  
e erdhë e të rrëmbyenë,  
si ujqër të pandiesm! 2)  
Të shpunë të të gjykonjë  
ndë avlli të Pillatit,  
qiturë shahit jallanxhi, 3)  
që të të turpërojnë!  
Të ndynjë e të pështynjë  
e të rrah' e të shanë,  
me të math zë thërrisnë  
ati Pillati: vrae!

Vallë ç' u pate bër', o bir,  
a ç' të lig' u punove,  
që mbë kryq të mbërthyenë  
e vdekë që të dhanë? 4)  
Po ti, sikundër qe e thën', o bir,  
si perëndi të ngrihesh,  
të ngjallesh prej të vdekurish,  
të shpëtojç njerëzinë,  
ata që të besuanë,  
se erdhe u trupëzove,  
e u bëre njeri për ta  
e gjithë këto i vove 11)  
me gjak të shënjtëruarë,  
që për ata derdhe,  
që t' i shpëtoje pej shejtanit 12)  
e përsëri t' i shpiesh  
ndër paradhisht e ndë konakt  
tek i vura përpara,  
që të të lavdurojnë  
ndë jetë të posaçme."

Poezia është një shqipërim i lirë nga greqishtja.

1. Shpëtimnë: shpëtimtarin.
2. Të pandiesm: të pandjenja, të pamëshirshëm.
3. Shahit jallanxhi: dëshmitar i rremë.
4. Vdekë: vdekje.
5. Vove: vuajte.
6. Pej: prej

## Ata që e nderojnë Beratin

### Adriana

E fillova me këtë zonjë të nderuar, jo se e kam mëhallalie e që me kënaqësi do doja ta blatoja përditë me lulet më të bukura nga bahçeja e babait tim, por sepse prania e saj e përditshme përpara atij banaku më frymëzonte e më nxit vazhdimisht. Dhe ju, lexues i nderuar, e dini mirë se kur kupa mbushet “këtë radhë me virtuozyt”, një ditë prej ditësh ajo do të derdhet e do të shpërthejë me vezullimin e të gjitha ngjyrave të ylberit për atë që është mishërim i këtij virtuozyteti.

E quajmë Adriana Shpëtim Shehu. Ishte e vetmja nxënëse e liceut artistik “Ajet Xhindole” në Berat, që mbaroi për piano nga 12 nxënësit që e filluan por që nuk arritën ta shpien deri në fund. Duke folur për ato vite, ajo kujton me admirim udhëheqësin e saj artistik, pianistin e shquar veçanërisht si metodist, profesorin e saj që i vlerësoi talentin ia kultivoi dhe ia zhvilloi. “Edhe sot e kësaj dite, unë shpreh falenderimet dhe mirënjohjen ndaj profesorit Vladimir Kapo, që më mësoi e më nxori në jetë”. Më vjen mirë që Adriana shpreh mirënjohje ndaj profesorit të vet, por unë dashamirësi i Adrianës do të përgjigjesha: “-Vërtet ai të mësoi, por ishe ti e zonja, është edhe merita jote që me vullnet e pasion dite të mësosh, ndryshe nga ato që e lanë talentin të venitet gjatë viteve. Këtë e vërteton edhe fakti që mbas konkurimit Adriana u pranua në Akademinë e Arteve në Tiranë, të cilën e përfundoi me sukses, me udhëheqjen artistike të pianistes së mirënjohur Nora Çashku.

Mbasi mbaroi Akademinë u emërua në Tiranë si mësuese për piano.

Ja ç’thotë Adriana për vete:

- Me ndryshimin e sistemit dhe hapjen e rrugëve jashtë shtetit, shkova me burrin dhe vajzën e vogël në Itali. U vendosën më Rimini. Paraqita dokumentet e shkollës në Akademinë e Arteve të Pesarës, qytet 40 km larg Riminit. Atje u befasuan kur mësuam se në Shqipëri mësimi i pianos fillohej që në klasën e parë dhe vazhdonte për 16 vjet, kurse në Itali fillon nga klasa e gjashtë dhe vazhdon 10 vjet. Ata vlerësuan edhe programin. Megjithatë, qoftë për besueshmëri, qoftë për ekuivalencë programesh m’u desh diploma e asaj akademie. Bëra kërkesën për t’iu nënshtuar provimeve dhe u aprovua. Kështu ia “fillova” nga e para. Nuk ishte e lehtë, ashtu sikurse nuk është i lehtë çdo fillim në tokë të huaj. Të duket vetja sikur je në mes të një pylli të dendur, ku nuk hyn asnjë rreze dielli për orientim, por Zoti është i madh. Ai kishte rezervuar për mua një fije shprese. Në atë mori njerëzish pata rastin të njihem me profesoren e kantos dhe të pianos, Ivonne Valpondi me nivel të lartë profesional. Shumë shpejt ajo zbuloi aftësitë e mia profesionale, talentin tim si pianiste. “Ne u binjakëzuan”. Nëpërmjet disa koncerteve që dhamë bashkërisht, qyteti bregdetar Rimini e mësoi se jo shumë larg, matanë Adriatikut, jetojnë edhe njerëz që e çmojnë të bukurën, e duan artin, e njohin jo më pak se në Itali e gjetkë në Evropë. Duartrokitjet mbas koncerteve nuk ishin vetëm për mua. I përkisnin atdheut tim, popullit tim, Beratit që më rriti e më edukoi. Dhe unë në biseda me italianë jo rrallë kam përdorur shprehjen shumë të njohur te ne “pyll pa derra nuk ka”. Kuptohet ku aludoja. Punova si pianiste në një kolegji privat. Lodhesha jashtë mase. Nga njëra anë detyrimet si bashkëshorte, si nënë, si amvisë shtëpie, dhe nga ana tjetër ecejaket në Rimini, në Pesaro, për të ndjekur seminarët a për të dhënë provimet, me një fëmijë- djalë të porsalindur në krah, ishin një barrë e rëndë sa një mal që duhej përballuar. Fitova simpatinë e banorëve të lagjes ku banoja. Ata thoshin: “- Adriana kërkon të ngjitet në “golgota”, se nuk e njihnin çukën e Tomorit. Reputacioni në rritje bëri që edhe në Itali filluan të sillnin fëmijët tek unë për mësimin e pianos që në moshë të vogël. Nxënësit e mi kanë fituar konkursin për në konservator. Vitin e kaluar e fitoi Simone Pari. Një nga anëtarët e komisionit (pianist gjerman), i befasuar nga interpretimi i lartë i nxënësit tim, i drejtohet: “Cili pianist ju ka përgatitur? Ai iu përgjigj “Një pianiste shqiptare”. Veprimtaria ime shtrihet edhe më gjerë. Çdo të shtunë e të diel shoqëroj në organo korin e fëmijëve në kishën “Shën Giralamo”-s në Rimini. Në çdo festë fetare japim koncerte: unë në organo, vajza ime në kor. Jemi interpretues në ato koncerte. Suksesi është i padiskutueshëm. Me kërkesë të komunitetit këtë vit nën drejtimin tim do të fillojë përgatitja e organistëve të vegjël për të interpretuar në kishë. Shqipëria ka emër të mirë me rininë. Kështu përfundon Adriana.

Në vend të epilogut

Adriana çdo vit gjatë pushimeve vjen në Berat. Kjo tregon se rrënjët e saja janë këtu, të thella e të shëndetshme.

**Fatmir Berati**

---

### NJË URË MIDIS DY BRIGJEVE

Në muajin qershor 2003 në qytetin e San Benedetto e të Ankonës e Fabriano të rexonit të Markesit me rreth 2 milionë banorë, fotografi e poeti Namik Selmani hapi për komunitetin italian e atë shqiptar ekspozitën e tij fotografike me temë BERATI – QYTETI I NJËMIJË DRITAREVE, të cilën e kishte hapur më 30 prill 2003 në galerinë e artit

“EDWARD LEAR” të Beratit. Ekspozita u prit ngrohtësisht nga vizitorët, ndërsa vetë ai po përgatit tashmë një tjetër ekspozitë kësaj radhe me vlerat e qytetërimit italian që do ta paraqesë pas një kohe të shkurtër para artdashësve shqiptarë dhe atyre italianë. Me këtë rast po botojmë një reportazh me mbresat e tij nga qyteti i Fabrianos.

Të ulur pranë shatërvanit gjigand të qendrës historike të qytetit të Fabrianos, bisedonim për bashkëjetesën mes shqiptarëve e italianëve në këto treva. Përpara mrekullisë së qytetit dhe emocionit të bisedës harruam pa rruftur kafënë. Ishin çaste ku respekti për këtë kulturë 2300- vjeçare po kthehej në një ngrohtësi, në një lloj krenarie se edhe unë po vija nga një qytet që kishte të njëjtën moshë qytetërimi, të njëjtën lashtësi, por me halle të ndryshme në kohët moderne.

### **Befasitë e Fabrianos**

Kur prek kalldrëmet e saj, kur hap dyert e rënda të dhjetëra muzeve të shumëllojshme, kur ndodhesh para dhjetëra e dhjetëra monumenteve të kulturës, të artit me moshë dhjetëra e dhjetëra shekullore në të gjitha skajet e qytetit, ndieje atë forcë që të jepë vitaliteti kulturor i një qyteti e i një vendi. Ngado që të vije e kushdo që të ishe, këtu merrje mesazhin e madh se një komb që nuk e harron e nuk e zhvleftëson, por e mbron dhe e zhvillon më tepër atë, ka më tepër individualitet, forcë e personalitet.

Çdo shqiptar, i cili qoftë dhe një herë shkel në këtë qytet, ndodhet përpara befasive të panumërta e të këndshme. Këtu ndodhet i pari Muze i Letrës së Filigramit në Evropë. Nëse makineritë e paraqindra viteve sot ndodhen në muze, të tjera më moderne vazhdojnë të prodhojnë për mbarë botën një nga mallrat më të kërkuara nga botuesit e artistët e të gjitha kohërave.

Në mënyrë figurative Fabrianon mund ta quajmë Qyteti i Nënave të Botës. Pikërisht në të dalë të qytetit, në ndërtesa joshumëkatëshe, është shpërndarë rrjeti i fabrikave të ARISTONIT, që prodhon me mijëra e mijëra, mbase me miliona mjete elektroshtëpijake, kryesisht makina larëse, duke marrë më vonë urimet e nënave të botës për cilësinë e lartë të këtyre mallrave aq të domosdoshme. E, natyrisht, në këtë kompleks gjigand, jepnin ndihmesën e tyre edhe shqiptarët. Njëri prej tyre ishte Shevali. Ishte guzhinier që prej shumë vitesh në një nga fabrikat e Aristonit dhe ishte i kenaqur me pagën. Madje, ai shpesh merrej nga italianët edhe në dasma si kuzhinier.

Një tjetër befasi që të ofronte qyteti, ishte një festival krejt i veçantë në llojin e vet në mbarë Evropën, me të cilin mburreshin fabrianezët e për të cilin kujdeseshin për detajin më të vogël. Për çdo vit në qendrën e qytetit, lulet e shumëllojshme, jo thjesht për një ekspozitë, viheshin përpara piktorëve nga Evropa e mbarë bota për t'u pikturuar. E, natyrisht, edhe turistët e ndiqnin atë festival të shumëpritur. Spanjollë, gjermanë, francezë, anglezë etj, ishin përherë të pranishëm këtu. Mendimi i parë që të vinte ishte edhe mundësia për të nisur edhe në Berat një traditë të tillë. Nuk mungojne lulet në këtë qytet, lulishtarët, të pasionuarit pas tyre, por dhe piktorë që i duan ato nuk janë pak...

### **Mbijetesë shqiptare..**

Diku pranë qendrës së qytetit në një shtëpi karakteristike italiane për dy ditë ishim mysafirë të Hajredin Kazës, kryetar i shoqatës atdhetare “UNITETI”, themeluar në këtë qytet që më 1994, para 9 vitesh. Ndoshta në pak rreshta është pak e vështirë të paraqesësh veprimtarinë atdhetare e kulturore duke shprehur qartë përfshirjen e plotë të komunitetit shqiptar në jetën shoqërore e kulturore italiane. Autor i katër librave me poezi të botuara kohët e fundit dhe një nga pje-sëmarrësit aktiv të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni, Hajredini kishte një popullaritet mes shqip-tarëve e italianëve. Shtëpia e tij ku me kaq ngrohtësi e respekt të pret zonja e tij Hida, është një lloj ode shqiptare për shqiptarë nga të gjitha trojet etnike, por edhe për personalitete italiane të kulturës, politikës, artit italian Pas një pritjeje tepër të ngrohtë që na u rezervua në zyrat e komunës së Fabrianos për projekte të tjera kulturore në të ardhmen, në shtëpinë e tij erdhi zoti Xhankarlo Sakranoli, aktualisht zëvendëskryetari i rajonit të Markesit që u befasua nga bukuritë e qytetit të Beratit në Ekspozitën Fotografike. Hajredini kishte miqësi e letërkëmbim me miq nga Kanadaja, Gjermania, Zvicra, Belgjika, Shqipëria, Kosova, nga Gostivari i tij i lindjes ...Personalitete të tilla si Anton Berisha, Fadil Sulejmani, Simon Kuzhnini shpesh e vizitonin Fabrianon për të nxitur çështjen shqiptare. Projektet për mbijetesën shqiptare kanë vazhduar me hapjen e shkollës shqipe “Adem Jashari”, që mbush atë zbrazëti të jetës së emigracionit sidomos të shqiptarëve.

Ne zyrën e tij, por dhe në shtëpi, kishte dy biblioteka me libra shqipe që do t'i kishte zili edhe ndonjë qytet. Madje atje ishte një rregull i tillë: çdo shqiptar që vinte për vizitë, sillte një sasi librash shqip për ta pasuruar atë.

## DERA E HAPUR E MIKPRITJES

Italianët janë njerëz tepër miqësor e xhentil. Tepër paqësor e të edukuar. Këtë e pamë në vizitën që bëmë në teatrin “Gentile” ku takuam një veteran të luftës, në rrugë, në kafene, në supermarketet. Kur pata mundësinë që të tregoj me ekspozitën time fotografike vlerat e qytetërimit 2400 vjeçar, të Beratit preka edhe një cilësi tjetër të tyre, atë të dashurisë për artin e respektin për historinë e kulturën e një vendi tjetër. Edhe pse integrimi i shqiptarëve ishte i dukshëm, gjeje mjaft prej tyre që mendonin të ktheheshin në atdhe. “Jam mirë, – na thotë Hyseni, një emigrant nga Tetova, - por prapë dua ta pi kafënë në vendin tim, të investoj për vendin tim”

Deri vonë Fabrianoja jetonte jetën e vet në mënyrën e vet. Në një lokal mjaft karakteristik, në ritmet e muzikës, mjaft të rinj argëtoheshin miqësisht. Asnjë grindje. Asnjë problem për qetësinë e qytetit. Mbrëmjet jo shumë të zhurmshme, por të bukura, ia linin vendin mëngjesëve të punës. Të nesërmen në gjigandin e Aristonit do të ndërroheshin turnet. Në muzetë e panumërta e në kisha do të hapeshin dyert e rënda për vizitorë të panumërt. Do të vaditeshin sërish lulet për të mos u tharë kurrë. Arkitektët e qytetit projektonin të tjera vepra për këtë qendër të rëndësishme të kulturës italiane mes Apenineve e Umbrës. Mes këtyre njerëzve punëtorë, artdashës ishin edhe bashkëshqiptarët e mi që, së bashku me vendasit, mbanin të gjallë urën e miqësisë mes dy kombeve....

Namik Selmani

---

## Debat

### Për një Berat kulturor... ndryshe

Stafit të Gazetës “Lajmëtari i Beratit”

z. Agim Mehqemeja, kryeredaktori i Gazetës

Ju uroj me gjithë zemër suksese në udhën e bukur e të vështirë të publicistikës. Me daljen në publik të gazetës, qyteti ynë fitoi një vlerë të re pluraliste që i kishte munguar. Me shumë gazeta, TV lokale, do të thotë më shumë liri, më shumë demokraci. Mua, personalisht, si qytetar, por edhe si detyrë, gazeta juaj më pëlqen, sepse po zbulon thesaret e kulturës materiale e shpirtërore të qytetit mijëvjeçar. Padyshim që një gazetë ka politikën e saj të botimit e të interesave të saj, edhe komerciale, por gazeta juaj në thelb është gazetë që iu drejtohet intelektualëve. Kam një sugjerim: për mua emri “Lajmëtari i Beratit”, nuk është titull publicistik, është një titull jo ngacmues. Është e drejta juaj që të gjykoni për titullin e gazetës, por unë do të sugjeroja që të gjendej një titull nga lashtësia, nga kultura jonë mijëvjeçare ose dhe mund të organizohej një konsultë me historianë, studiues, njerëz të artit e të kulturës së qytetit etj. Gjithsesi është një mendim i personal. Unë do të bashkëpunoj ngushtë, do të jap edhe informacione, siç do të doja të kishte më shumë debat në faqet e gazetës suaj.

Megjithatë është fillimi. Dhe fillimi është i mbarë, sepse ka një staf profesional.

Urime, Kadri Kuka

\* Në fund të muajit shtator, projekti do t’i paraqitet këshillit bashkiak...

Në vend të hyrjes

Kam afro tre vjet që punoj në Bashki dhe që drejtoj kulturën. Nuk dua të flas për ato që janë bërë, por dua që t’i ftoj të gjithë, pushtetarë, deputetë, biznesmenë, qytetarë, intelektualë, artistë që të ulen në një tryezë dhe të hartojnë një projekt të fuqishëm për ta bërë Beratin qytetin e parë në Shqipëri në fushën e artit e të kulturës.

Unë personalisht kam ambicje që Berati me resurset e tij kulturore të afishohet edhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Dua që të ftoj në debat të gjithë të interesuarit sepse duhet të kalojmë nga faza sporadike, nga empirizmi, nga veprimtari të shkëputura në një “masterplan” kulturor, që, padyshim, do të kërkojë të bashkojë mendjet dhe forcat kulturore të qytetit të Beratit që jetojnë brenda dhe jashtë tij.

Në pozicionin e detyrës që kam si Drejtor i Kulturës në Bashki, unë dua të shpalos vizionin që kam, po që përmes faqeve të gazetës “Lajmëtari i Beratit” ftoj që të “përplasen” edhe ide e projekte të tjera.

Statusi i veçantë kulturor është në nderin e këshillit bashkiak që t’i japë qytetit të Beratit statusin e veçantë të trajtimit financiar në fushën e artit e të kulturës. Që në projekt buxhetin 2004 e në vazhdimësi duhet që të ketë një buxhet ekstra për kulturën.

Mund të duket si utopi, por nisur nga veçoria e të qenurit një qytet i rrallë, unikal, kulturor në llojin e vet, padyshim që të zhvillohet arti e kultura në qytetin e Beratit, kërkon një ndryshim 100 % të mentalitetit për artin e kulturën. Një buxhet ekstra mbi bazën e projektit madhor që do të përfundojë për një afat 3-6 muajor, do të mundësojë dhe të krijojë të gjitha kushtet që Berati dora-dorës të klasifikohet në qytet - lidërsip kulturor në shkallë vendi.

Unë mendoj që lënda e parë kulturore jo vetëm materiale, por edhe shpirtërore ekziston, por nuk ka patur një vizion dhe projekte konkrete. Dhe unë si qytetar, por edhe si detyrë, dua të inicioj që Bashkia me stafe profesionistësh, në studimin e afërt dhe perspektivë, në fushat e kulturës materiale e shpirtërore, të përcaktoj

qartë objektet kulturore, politikat kulturore, permanente, zhvillimet parësore, humanizmin e tyre dhe të ndërtojnë qytet kulturor të veçantë nga qytetet e tjera.

Cila janë ambiciet kulturore dhe vizioni për të ardhmen e afërt?

Berati ka një ndërtim arkitektonik që ia ka faluar natyra dhe brezat. Lagjet muzeale, si Gorica, Mangalem, Kalaja janë perla.

### **Sa dhe si i shfrytëzojmë?!**

Ka filluar një lëvizje kulturore -tregtare në Kala, por ajo duhet shtrirë dhe përkrahur më gjërë nga pushteti vendor, biznesmenë, qytetarë etj.

Si hap i parë unë gjykoj që specialistët më të zotë të qytetit, njerëz të cilët duan që Berati të çertifkohet si qytet kulturor, të paraqesin projektin, opsionet e tyre. Këtë nismë së afërmi do ta realizojë Bshkia e Beratit por unë kam si qëllim që kjo nismë të mos jetë vetëm zyrtare, por të ndërgjegjësojë institucionet kulturore, njerëzit e artit e të kulturës, studiuesit, specialistët.

Cilat janë hapat konkrete që duhen hedhur?

Mendoj që sa më parë duhet ngritur një komision i cili të ketë nënkomisionet e veta, për të paraqitur brenda muajit shtator-tetor projektin madhështor të ndarë në blloqe dhe faza. Projekti gjykoj që duhet të jetë përfshirës, duke marrë në konsideratë gjithë zhvillimet urbane, ekonomiko-kulturore dhe ato infrastrukturore. Objeksione të afërta e të largëta duhet të jenë risjellë në kushtet e ekonomisë së tregut e institucioneve kulturore në një fizionomi e organik tjetër. Kështu p.sh Pallati i Kulturës mund të kthehet në një qendër arti, të ketë "bijëzat" e saj në lojërat periferike, të funksionojë treni i kukullave, teatri dhe spektakli në natyrë, të jepen koncerte të grupeve orkestrale, të organizojë ekspozita fotografike, etnografike, të ngrejë merkato libri, qendra kulturore për moshën rinore, t'ju jepen përparësi dhe kushte lehtësuese fiskale afaristëve për të ndihmuar artin, të shtohen e të mbështeten fillimisht grupe kulturore të rinjve, të muzikës popullore, të përshtaten e të funksionojnë diskoteka, klube nate, të organizohen në mënyrë të përvitshme festivale lokale, gara hipizmi, panairë librash, pijesh, gdhendjesh në dru, gurë, qeramikë, të botohen libra, guida. Vepra të tilla janë zhvilluar por ato kanë qenë sporadike, e rëndësishme tashmë është që të ketë projekte, të ketë financime, të ketë një master plan ...

Padyshim që në ekonominë e lirë të tregut, shumë gjëra i vendos vetë tregu, por unë këmbëngul që Berati do një përkudësje të veçantë, do një trajtim ndryshe nga qytetet e tjera.

P.sh: një fushë e rëndësishme e vjeljes së të ardhurave është turizmi. Ka vërtet një turizëm familjar, ka edhe lokale të mrekullueshme, por çfarë politika ka për të mbështetur biznesin, për t'i lehtësuar qytetarët nga ana financiare? Është bërë pak, më shumë duhet bërë për turizmin familjar, për thithjen e të huajve. Fakti që së shpejti do të vendoset teleferiku e njerëzit do të shkojnë në një pikë të mrekullueshme siç është Sheshi i Dosave, është një hap inkurajues. Njerëzit e artit e të kulturës (është fjala për artin e vërtetë), duhen mbështetur, duhen përkrahur, duhen inkurajuar. Tashmë koha kërkon që Berati të zgjohet përfundimisht nga një indiferentizëm kulturor, të flakë paaftësinë, të flakë nga institucionet njerëzit që janë më tepër afaristë sesa artistë dhe të mendojë që Berati të fitojë vlera të reja. Por pa politika, pa financime, pa njerëz të përkushtuar e të zotë, kjo nuk mund të realizohet.

### **Edhe një kërkesë tjetër ....**

Padyshim që thithja e donacioneve është një rrugë tjetër e ndryshimeve, e kthimit të qytetit të Beratit në një qytet kulturor. Por unë do t'i bëjë një apel Qeverisë, Ministrisë së Kulturës, të Turizmit, Institutit të Monumenteve të Kulturës që Beratin, Gjirokastrën, Krujën e ndonjë qytet tjetër, t'i trajtojë me status të veçantë, e kam fjalën në fushën e kulturës. Investimi për qytete të tilla si Berati është një investim për kombin, është një investim për brezat.

### **Debati është i hapur ...**

Duke mirëpritur ide, mendime, projekte, për të kaluar edhe në kanale zyrtare projektin përfundimtar, ftoj studiues, njerëz të artit, të kulturës, pushtetarë, biznesmenë, median e shkruar dhe elektronike që të nderojnë gjithë opinionin. Nuk është utopi të kthesh Beratin në një qytet me pesha kulturore në gjithë vendin dhe jashtë tij.

Kadri Kuka

Drejtor i Kulturës, Rinisë e Sporteve,

Bashkia Berat

---

### **Prononcohet anëtari i këshillit bashkiak**

Është punë e vështirë të jesh këshilltar bashkie në opozitë, sidomos kundër kartonave të kuq. Pse do thoni ju? Ngrita një problem për këndin e lojrave në parkun “Dëshmorët e Kombit”. Më premtuan se do të vinte fondi. Më gënjyen sa deshën. Më mbytën me premtime sa u ngopën ata dhe unë bashkë me ta. Më ka ngelur peng dhe merak se po vjen fundi i mandatit tim dhe nuk munda që të realizoja atë që i kisha premtuar vetes dhe elektoratit që më besoi. Kjo jo shumë për fajin tim. Nejse, këndi i lojrave nuk u realizua dhe nuk besoj se do të realizohet. Berati, si qytet -muze, nuk ka asnjë ekip lojërash me dorë, nuk ka sheshe ku të luajnë dhe të zbavitet rinia, të dalin elemente sportive, të dalin disa ekipe që të përfaqësojnë rrethin. S’ka as kënde lojërash, fusha sportive, e aq më keq pallat sporti. Mburret bashkia se bëri për vitin e ri një aktivitet në sheshin para turizmit. Pse, për atë ka nevojë vetëm rinia?

Berati, qyteti me kulturë 2400- vjeçare, është pa kinema, pa estradë, pa një ansambël këngësh e vallesh. E si mund të ecet kështu, e si mund të themi se kemi punuar për Beratin kur u betuam në fillim të kësaj legjislature? Prandaj me plot gojën mund të themi se Berati është qytet apatik, pa gjallëri. Ne ia shtojmë duke mos zhvilluar veprimtari. Atëherë si i paskemi punët mirë? Po si mund të mburremi dhe të themi se ne i kemi bërë tërë punët, kur nuk ka sport, kulturë, art? Populli i Beratit është shumë i ndjeshëm ndaj këtyre dukurive.

Si mund të lësh aktor të njohur si Cekja që ta përdorin qytetet e tjera? Ne kemi shumë sportistë të talentuar që me pak stimulim, të kishin ngritur jo një ekip volejboli, basketbolli për meshkuj dhe që femra, por disa. Unë jetën e bashkisë nuk e mat me 300-400 m rrugë të asfaltuar, që është detyrë dhe sponsorizohet nga donatorë. Do bashkia apo, s’do bashkia këtë punë do të kryhen.

Për çfarë aktivitete mund të flasësh, kur ato duan shumë punë e mund? Unë një gjë nuk kuptoj. Aty ka një staf kulture e një drejtues sporti. Bëj pyetjen: Po s’u morën me kulturën dhe sportin me se merren këta?

Pra, siç e thashë edhe në fillim, më vjen shumë keq që në këtë legjislaturë nuk mundëm t’i realizonim këto premtime.

**Robert Bushati**

**Anëtar i këshillit bashkiak në partinë BK**

---

### **Ekipi i Beratit në kampionatin kombëtar të notit**

#### **Lart:**

Nail Fuga,

Qerim Hysenbegasi, Agim Mehqemeja, Hajri Bajraktari, Pajtim Polovina, Enver Drenova.

#### **Poshtë:**

Besnik Rexhepi, Agim Gjoni, Leonidha Mërtiti, Shkëlqim Vrioni, Yzedin Shelegu, Dhimitër Topi.

### **Turistët suedez luajnë vaterpol në Osum**

#### **Berat, 1986**

Ditë e diel. Paradite.

Një grup turistësh suedez gjatë vizitës në kalanë e qytetit, i kishte tërhequr bukuria e qendrës së vaterpolit në Osum.

Turistët bëjnë një kërkesë që të lejoheshin të luanin disa orë në qendrën e vaterpolit. Turistët luajtën 4 orë. Ata u larguan, pasi panë edhe fiksuan pamje nga pjesa e parë e finales,

## **Lundra e xha Janit**

Kështu quhej lundra me pronar Jani Gajda nga lagja “Mangalem”. Lundra lidhte lagjen Goricë me pjesën tjetër të qytetit. Ajo përdorej për të shkurtuar distancën nga rruga që do të bëhej nëpër Urën e Goricës. Herët në mëngjes xha Jani qëndronte ulur mbi postaqe, brenda një kioske ku kalimtarët bënin pagesën. Lundrën e ngiste një punëtor. Ajo ishte e gjatë 8 m dhe mbante zakonisht 10-12 vet. Në kohën kur Osumi vinte rrëmbyeshëm lundra nuk punonte. Lundra vazhdoi të përdorej deri në vitin 1947. Në disa kampionate lokale të notit, notarët e fillonin startin e garave mbi lundër.